

GJYKATA E APELIT
PRISHTINË

Numri i rastit: PAKR 158/17

Data: 7 dhjetor 2017

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Jorge Martins Ribeiro si Kryetar i kolegjit dhe Gjyqtar Raportues, dhe Gjyqtari i EULEX-it Krassimir Mazgalov dhe Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit të Kosovës Hava Haliti si anëtarë të Kolegjit, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor të EULEX-it Timo Torkko si Procesmbajtës, në rastin P. nr. 61/2016 para Gjykatës Themelore të Mitrovicës kundër:

R.R.;

M.V.;

të akuzuar në bazë të Aktakuzës së Prokurorit të EULEX-it në Prokurorinë e Shtetit në Mitrovicë, datë 7 maj 2014 (dorëzuar në gjykatë më 8 maj 2014), dhe sipas Aktakuzës së ndryshuar të datës 7 shtator 2016 për veprat penale:

- I.** Vrasje e Rëndë, e përshkruar dhe e dënueshme sipas Neneve 146 dhe 147 (4), (6), (8) dhe (10) të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPK), UNMIK/REG/2003/25 lidhur me Nenin 23 të KPK *pari materia* të Neneve 178 dhe 179 (1.5), (1.7), (1.9) dhe (1.10) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodi nr.04/L082 (në tekstin e mëtejshëm "KPRK"), lidhur me Nenin 31 të KPRK;

- II.** Vrasje e rëndë në tentativë, e përshkruar dhe e dënueshme sipas Nenit 146 dhe 147 (4), (6), (8) dhe (10) i KPK lidhur me Nenin 20 dhe 23 të KPK *pari materia* Nenit 178 dhe 179 (1.5), (1.7), (1.9) dhe (1.10) të KPRK lidhur me Nenet 28 dhe 31 të KPRK;

- III.** Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, e përshkruar dhe e dënueshme sipas Nenit 328 (1) dhe (2) të KPK lidhur me Nenin 23 KPK *pari materia* Nenin 374 të KPRK lidhur me Nenin 31 të KPRK;
- IV.** Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare të përshkuara dhe të dënueshme në bazë të Nenit 316 (1) dhe (3) të KPK-së, lidhur me Nenin 23 të KPK *pari materia* Neni 409 (1) dhe (2) të KPRK si të lexuar në lidhur me nenin 31 të KPRK-së;
- V.** Rrezikimi i trafikut publik me veprime ose mjete të rrezikshme, e përshkruar dhe e dënueshme sipas Nenit 299 (1) të KPK, lidhur me Nenin 23 të KPK, *pari materia* Neni 380 (1) i KPRK, lidhur me Nenin 31 të KPRK;
- VI.** Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, e përshkruar dhe e dënueshme në Nenin 291 (1), (3) dhe (5) të KPK, lidhur me Nenin 23 të KPK-së, *pari materia* Neni 365 KPRK, lidhur me Nenin 31 të KPRK;
- VII.** Pjesëmarrje në një turmë që kryen veprë penale e përshkruar dhe e dënueshme sipas Nenit 320 (1) të KPK, lidhur me Nenin 23 të KPK *pari materia* Neni 412 të KPRK, lidhur me Nenin 31 të KPRK.

duke vendosur sipas ankesave të parashtruara nga Prokurori i EULEX-it më 27 shkurt 2017, nga avokati mbrojtës A.L. në emër të të pandehurit M.V. më 24 shkurt 2017 dhe mbrojtësit Z.J. në emër të të pandehurit R.R. më 1 mars 2017 kundër Aktgjyqimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. nr. 61/2016, datë 21 nëntor 2016;

pas shqyrtimit të përgjigjes së parashtruar nga Prokurori i EULEX-it më 6 mars 2017;

pas shqyrtimit të plotësimit të ankesës së mbrojtësit Z.J. në emër të të pandehurit R.R. më 11 prill 2017;

dhe propozimit të Prokurorit të Apelit të paraqitur më 13 prill 2017;

pas mbajtjes së seancës publike të Kolegjit të Apelit më 26 tetor 2017;

u këshillimit dhe votimit më 10 nëntor 2017;

në pajtim me Nenet 389, 390, 394, 398 dhe 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPP);

nxjerrë këtë:

AKTGJYKIM

A) Gjykata e Apelit *ex officio* shpallë parashkrimin absolut të ndjekjes penale për sa i përket dy të pandehurve lidhur me veprën penale në pikën V, në pajtim me Nenin 299 (1) të KPK, lidhur me Nenet 90 (1.5) KPK, 91 (1 dhe 6) KPK. Në pajtim me Nenin 362 (1) dhe Nenin 363 (1.3) të KPP-së, pasi afati absolut i parashkrimit ka skaduar më 26 korrik 2017, gjykata e hedh poshtë akuzën në lidhje me veprën penale në pikën V të Aktakuzës.

B) Ankesa e ngritur nga Prokurori i EULEX-it më 27 shkurt 2017 kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. nr. 61/2016, datë 21 nëntor 2016, me anë të kësaj është aprovuar pjesërisht për të marrë parasysh ekzistimin e (vazhdueshëm) bashkëkryerjes në pikën IV, në pajtim me Nenin 23 të KPK.

Pjesa tjetër e ankesës është hedhur poshtë si e pabazë

C) Ankesa e paraqitur nga avokati mbrojtës Z.J. në emër të të pandehurit R.R. datë 27 shkurt 2017 kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. nr. 61/2016 të datës 21 nëntor 2016, që nuk përmban arsyetimin - të parashtruar me një kërkesë të mëvonshme të datës 8 mars 2017 - me këtë rast hidhen poshtë dhe nuk merren parasysh, për mosplotësimin e kërkesave ligjore të përcaktuara në ligj, në pajtim me Nenet 376 (1.1 .4 dhe 1.1.7) dhe (4) KPP, 379 KPP, 382 (1.2) dhe Neni 398 (1.1) dhe paragrafi 3 (përcaktimi i përbashkët i të gjitha ankesave të të njëjtit aktgjykim).

D) Ankesa e parashtruar nga mbrojtësi A.L. në emër të të pandehurit M.V. më 24 shkurt 2017 kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. nr. 61/2016, datë 21 nëntor 2016, në bazë të Nenit 398 (1.4) të KPP, është miratuar pjesërisht lidhur me zvogëlimin e dënimit .Dënimi i të pandehurit M.V. ndryshohet dhe të vendoset në 1 vit e 3 muaj burgim; periodha e verifikimit mbetet e pandryshuar (3 vjet).

Pjesa tjetër e ankesës është hedhur poshtë si e pabazë.

E) Duke e pasur parasysh zvogëlimin e dënimit të të pandehurit M.V., për shkaqe që nuk janë ose thjesht të natyrës personale, në pajtim me Nenin 387 (1), 394 (1.4) dhe 397 (*beneficium cohaesionis*) KPP, dënimi i të pandehurit R.R. është ndryshuar dhe vendosur në 1 vit e 9 muaj burgim; periudha e verifikimit mbetet e pandryshuar (4 vjet).Ashtu si në aktgjykimin e kundërshtuar, në pajtim me Nenin 73 (1) të KPK-së, koha në paraburgim dhe privim nga liria nga data 11 prill 2014 deri më 22 prill 2015 duhet të përfshihet (zbritet) në dënimin në rast se dënimi i pezulluar është revokuar .

F) Në përputhje me Nenin 398 (1.4), lidhur me Nenin 370 (1 dhe 2) dhe 403 të KPP, korrigjon datën e aktgjykimit original në 7 shkurt 2017 pasi që përputhet me datën që është dërguar për përkthim dhe përcakton se kur dosja e lëndës i kthehet Gjykatës Themelore të Mitrovicës, zyrtari i regjistrit, i cili është ende anëtar i personelit të EULEX-it, duhet të nënshkruajë aktgjykimin original dhe do ta paraqesë atë sipas datës kur ajo ndodhë, pas përcaktimit nga kjo Gjykatë e Apelit.

G) Në pajtim me Nenin 370 (1 dhe 2) në aktgjykimin e shkallës së parë ku është shkruar Neni "318 (2)" KPK është një gabim shtypi që duhet të lexohet Neni "318 (1) KPK" - në pajtim me paragrafin e fundit faqja 39 e versionit Anglisht të aktgjykimit të kundërshtuar.

H) Në dispozitiv dhe deklarimin e bazave ku të pandehurit janë shpallur fajtorë për veprën penale të Pjesëmarrjes në Grupin që pengon personat zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare sipas Nenit 318 (1) të KPK, referencë në Nenin 23 të KPK, bashkëkryerje, është duke u bërë tani.

I) Sa i përket pjesës tjetër, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. nr. 61/2016, datë 21 nëntor 2016, me këtë rast vërtetohet.

ARSYETIMI

I. HISTORIKU RELEVANT PROCEDURAL

1 - Më 08 maj 2014, Prokuroria e Prokurorisë së EULEX-it në Mitrovicë ngriti Aktakuzën PP.nr. 103/2011 datë 7 maj 2014 kundër të pandehurve R.R. dhe M.V., duke i akuzuar ata për veprat penale "Vrasje e Rëndë", e përshkruar dhe e dënueshme sipas Neneve 146 dhe 147 paragrafët (4), (6), (8) dhe (10) të KPK, lidhur me Nenin 23 të KPK, "Vrasje e rëndë në tentativë", e përshkruar dhe e dënueshme sipas Neneve 146 dhe 147 paragrafët (4), (6), (8) dhe (10) KPK lidhur me Nenet 20 dhe 23 të KPK, "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", e përshkruar dhe e dënueshme sipas Nenit 328 paragrafët (1) dhe (2) të KPK lidhur me Nenin 23 të KPK, "Pengimi i Personave Zyrtarë në Kryerjen e Detyrave Zyrtare" e përshkruar dhe e dënueshme sipas Nenit 316 (1) dhe (3) të KPK, lidhur me Nenin 23 të KPK, "Rrezikimi i trafikut publik me veprime apo mjete të rrezikshme" e përshkruar dhe e dënueshme sipas Nenit 299 (1) të KPK lidhur me Nenin 23 i KPK, "Shkaktimi i Rrezikut të Përgjithshëm", e përshkruar dhe e dënueshme sipas Nenit 291 (1), (3) dhe (5) të KPK, lidhur me Nenin 23 të KPK dhe "Pjesëmarrje në një turmë që kryen vepër penale", e përshkruar dhe e dënueshme sipas Nenit 320 (1) të KPK lidhur me Nenin 23 të KPK.

2 - Seanca e shtyrimit të parë gjyqësor në çështjen penale 59/2014 u hap më 19 janar 2015 dhe përfundoi më 20 prill 2015, me lirimin e të dy të pandehurve nga të gjitha akuzat kur u shpall vendimi. Bazuar në atë vendim, të dy të akuzuarit, R.R. dhe M.V. u shpallën të pafajshëm për të gjitha akuzat.

3 - Më 08 qershor 2015, Prokurori parashtrroi ankesë kundër aktgjykimit të përmendur të Gjykatës së Shkallës së Parë.

4 - Pas Ankesës së Prokurorit të EULEX-it të paraqitur kundër atij Aktgjykimi, më 29 prill 2016, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Vendimin e saj PAKR 355/2015, e miratoi ankesën, e anuloi Aktgjykimin dhe lëndën e ktheu në Gjykatën Themelore të Mitrovicës për rigjykim.

5 - Më 7 shtator 2016, Prokurori i EULEX-it e ngriti aktakuzën e ndryshuar me veprat penale në vijim në lidhje me të dy të pandehurit:

- I. Vrasje e Rëndë, e përshkruar dhe e dënueshme sipas Neneve 146 dhe 147 (4), (6), (8) dhe (10) të Kodit Penal të Kosovës, UNMIK/REG/2003/25 (në tekstin e

mëtejshme KPK) lidhur me Nenin 23 KPK *pari materia* Nenet 178 dhe 179 (1.5), (1.7), (1.9) dhe (1.10) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodi nr.04/L082 (në tekstin e mëtutjeshëm "KPRK"), lidhur me Nenin 31 të KPRK;

- II. Vrasje e rëndë në tentativë, përshkruar dhe e ndëshkueshme sipas Nenit 146 dhe 147 (4), (6), (8) dhe (10) KPK lidhur me Nenin 20 dhe 23 KPK *pari materia* Nenin 178 dhe 179 (1.5), (1.7), (1.9) dhe (1.10) të KPRK lidhur me Nenet 28 dhe 31 të KPRK;
- III. Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, e përshkruar dhe e dënueshme sipas Nenit 328 (1) dhe (2) të KPK lidhur me Nenin 23 KPK të *pari materia* Nenin 374 të KPRK lidhur me Nenin 31 të KPRK;
- IV. Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare e përshkruar dhe e dënueshme në bazë të Nenit 316 (1) dhe (3) të KPK, lidhur me Nenin 23 të KPK *pari materia* Neni 409 (1) dhe (2) të KPRK lidhur me Nenin 31 të KPRK;
- V Rrezikimi i trafikut publik me veprime ose mjete të rrezikshme, e përshkruar dhe e dënueshme sipas Nenit 299 (1) të KPK, lidhur me Nenin 23 të KPK, *pari materia* Neni 380 (1) KPRK, lidhur me Nenin 31 të KPRK;
- VI. Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, e përshkruar dhe e dënueshme në Nenin 291 (1), (3) dhe (5) të KPK, lidhur me Nenin 23 të KPK, *pari materia* Neni 365 KPRK, lidhur me Nenin 31 të KPRK;
- VII. Pjesëmarrje në një turmë që kryen veprë penale e përshkruar dhe e dënueshme sipas Nenit 320 (1) të KPK, lidhur me Nenin 23 të KPK *pari materia* Neni 412 të KPRK lidhur me Nenin 31 të KPRK.

6 - Shqyrtimi kryesor për rigjykimin filloi më 7 shtator 2016 dhe u mbyll më 18 nëntor 2016. U dëgjuan në 11 ditë gjykim, të mbajtura më 07, 14, 15, 19, 20 dhe 26 shtator 2016, 07, 10 dhe 17 tetor 2016, 16 dhe 18 nëntor 2016 në prani të Prokurorit, palët e dëmtuara D.Z. dhe M.Z.,

përfaqësuesit e palëve të dëmtuara B.M. dhe E.P., i pandehuri R.R., avokatët e tij mbrojtës Z.J. dhe N.V., dhe i pandehuri M.V. dhe avokati i tij mbrojtës A.L..

7 - Më 21 nëntor 2016, Gjykata Themelore e shpalli Aktgjykimin në çështjen P. Nr. 61/2016, duke e bërë publik dispozitivin.

8 - Sipas aktgjyimit të lartpërmendur, të pandehurit u liruan nga akuzat në pikat 1, 2, 3, 5, 6 dhe 7 të Aktakuzës. Të pandehurit janë dënuar në pikën 4 për veprën penale Pjesëmarrja në Grupin që pengon personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare e përshkruar dhe e dënueshme sipas Nenit 318, paragrafi 2 të KPK-së.

9 - I pandehuri R.R. u dënua me 2 vjet burg, por në pajtim me Nenin 43, paragrafi 1, dhe Nenin 44, paragrafi 2, të KPK, dënimi nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen një tjetër veprë penale për një periudhë verifikimi prej katër (4) vitesh. Në lidhje me të pandehurin R.R., në pajtim me nenin 73 paragrafi 1 të KPK, koha e mbajtjes në paraburgim dhe gjatë heqjes së lirisë, nga 11 prilli 2014 deri më 22 prill 2015, është urdhëruar të përfshihet në dënimin e burgut në rast të revokimit të dënimit me kusht dhe ekzekutimit të dënimit.

10 - I pandehuri M.V. u dënua me 1 vjet e 6 muaj burgim, por në pajtim me Nenin 43 paragrafi 1 dhe Nenin 44 paragrafi 2 të KPK, dënimi nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen një tjetër veprë penale për një periudhë verifikimi prej tri (3) vitesh.

11 - Aktgjykimi iu dorëzua të pandehurit R.R. më 14 shkurt 2017 dhe mbrojtësit të tij Z.J. më 15 shkurt 2017. Shkresa e titulluar "ankesë" është dorëzuar më 1 mars 2017 nga avokati mbrojtës në emër të të pandehurit. Avokati mbrojtës paraqiti më vonë më 11 prill 2017 një shtesë në kërkesën e mëparshëm të titulluar "ankesë".

12 - Aktgjykimi i është dërguar të pandehurit M.V. më 11 shkurt 2017 dhe mbrojtësit të tij A.L. më 14 shkurt 2017. Ankesa është parashtruar më 24 shkurt 2017 nga avokati mbrojtës në emër të të pandehurit.

13 - Aktgjykimi i është dërguar Prokurorit të EULEX-it më 14 shkurt 2017 dhe Prokurori i EULEX-it e parashtrroi ankesën e tij më 27 shkurt 2017.

14 - Ankesa e M.V. u dërgua në Prokurorinë e EULEX-it më 1 mars 2017 dhe Prokurori i EULEX-it e paraqiti një përgjigje më 6 mars 2017 (388 (2) KPP).

15 - Parashtrësja "ankesë" e R.R. është dorëzuar në Prokurorinë e EULEX-it më 6 mars 2017 dhe Prokurori i EULEX-it e dorëzoi një përgjigje më 7 mars 2017 (388 (2) KPP).

16 - Ankesa e Prokurorit të EULEX-it iu dorëzua R.R. më 2 mars 2017 dhe avokatit të tij mbrojtës Z.J. më 3 mars 2017. Në emër të R.R. nuk është paraqitur asnjë përgjigje.

17 - Ankesa e Prokurorit të EULEX-it iu dorëzua M.V. më 3 mars 2017 dhe mbrojtësit të tij A.L. më 1 mars 2017. Në emër të M.V. nuk u paraqit asnjë përgjigje.

18 - Prokurorja e Apelit e paraqiti përgjigjen e saj më 13 prill 2017.

19 - Më 26 tetor 2017, Gjykata e Apelit e mbajti një seancë publike. Kolegji i Ankesave u këshillua dhe votoi më 10 nëntor 2017.

II. PARASHTRESAT E PALËVE

A. Ankesa e Prokurorit të EULEX-it

20 - Prokuroria i propozon Gjykatës së Apelit të shpallë të pandehurit fajtorë në pikat 1-3 dhe 5-7 të aktakuzës. Përveç kësaj, në pikën 4, Prokuroria i propozon Gjykatës së Apelit të shpallë të pandehurit fajtorë për veprën penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare sipas aktakuzës. Ankesa bazohet në përcaktimin e gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale dhe në bazë të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike sipas Nenit 383 (1.1), (1.2) dhe (1.3) të KPP.

21 - Prokuroria pohon si në vijim: Kryetari i trupit gjykues bëri një kërkesë për zgjatjen e afatit për nxjerrjen e aktgjykimit më 19 dhjetor 2016. Kërkesa u miratua nga Ushtruesi i detyrës së Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë në të njëjtën ditë. Për të qenë plotësisht në përputhje me dispozitat e Nenit 369 (1) dhe (2) dhe 370 (2) të KPP, data e aktgjykimit duhet të ishte pas datës 19 dhjetor 2016, duke qenë kjo data kur ishte miratuar kërkesa nga Ushtruesi i

detyrës së Kryetarit të Gjykatës Themelore .Përveç kësaj, në kundërshtim me dispozitat e Nenit 369 (2) të KPP, aktgjykimi nuk ishte nënshkruar nga nëpunësi i regjistrit.

22 - Të pandehurit janë akuzuar me bashkëkryerje në lidhje me kryerjen e krimeve për të cilat janë akuzuar në Pikat I, II, III. Prandaj, dhe sipas ligjit penal në fuqi, pjesëmarrja e të pandehurve në kryerjen e këtyre veprave penale nuk kërkon që ata të jenë në posedim të armëve, por që kanë kontribuar ndjeshëm në kryerjen e këtyre veprave penale.

23- Prokuroria gjithashtu i kërkon gjykatës të përcaktojë se veprimet e përmendura në Pikën IV ishin në bashkëkryerje, sipas Nenit 23 të KPK.

24 - Në pikën IV të Aktakuzës, sipas Prokurorisë, Gjykata Themelore gaboi në arsyetimin e saj të dispozitave të bashkëpjesëmarrjes e paraparë në Nenin 23 KPK *pari materia* me Nenin 31 të KP 2013. Nenet e përmendura kërkojnë që keqbërësi "*të marrë pjesë në një grup të personave që me veprime të përbashkëta ...*".Nuk është e nevojshme të zbatohet bashkëkryerja sipas Nenit 23 të KPK- ose 31 të KPRK . Gjykata Themelore nuk e ka marrë parasysh se të pandehurit kanë vepruar në bashkëpunim në avancimin e veprave penale në kryerjen e veprave penale. Zbatueshmëria e *bashkëkryerjes* është e nevojshme duke marrë parasysh rolet dhe pjesëmarrjen e të pandehurve në grup. Dispozitat e Pjesëmarrja në grupin që pengon personat zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare në kundërshtim me Nenin (2) të KPK-së nuk nënkupton që në të gjitha rrethanat, kur kjo akuzë është hedhur poshtë ndaj 2 ose më shumë të pandehurve, ekziston një supozim se të pandehurit do të vepronin në bashkëkryerje.

25 - Në pikat V dhe VI, Gjykata Themelore gaboi në arsyetimin e saj se dispozitat Rrezikimi i trafikut publik me veprime ose mjete të rrezikshme përmbajnë karakteristika të rëndësishme të Shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm. Dy veprat, siç mund të shihet në elementet e përcaktuara në dispozitat e tyre përkatëse, janë të ndara dhe të veçanta. Koncepti i *bashkimit real* të veprave penale të përmendura nga Gjykata Themelore është një përpjekje për të krijuar një koncept që është i panevojshëm dhe nuk parashikohet në dispozitat e KPK ose KPRK, si dhe në KPP. Gjykatat Themelore duke arsyetuar për sa i përket parimit të *bashkimit të vërtetë real, përputhjes* dhe *subsidiaritetit ideal* janë *ultra vires* pasi Gjykata Themelore gabimisht u largua nga kompetenca dhe juridiksioni i saj në interpretimin e ligjit në përpjekjen e saj për të zëvendësuar

dispozitat e ligjit, përkatësisht KPK dhe KPP me parimet ligjore teorike të cilat janë krejtësisht të parëndësishme dhe jo të zbatueshme.

26 - Lidhur me Pikën VII të aktakuzës, Gjykata Themelore gjeti në aktgjykimin e saj se ishte mendim i përgjithshëm se turma duhet të jetë më e madhe se shtatë (7) ose së paku dhjetë (10) persona. Prokuroria vëren se mendimi i Gjykatës Supreme më 21 tetor 2010, i cili thotë se në lidhje me Nenin 320 (1) të KPK Turma e mbledhur nënkuptonte 8 ose më shumë persona. Dispozitat e Nenit 412 të KPK të cituara në paragrafin e mësipërm theksojnë qartë se një turmë e mbledhur përbëhet nga tetë ose më shumë persona.

27 - Bazuar në atë që u tha më lartë, Prokuroria i propozon Gjykatës së Apelit që të modifikojë vendimin e kundërshtuar duke dënuar dhe dënuar të pandehurit në të gjitha akuzat sipas Aktakuzës. Nga ana tjetër, Prokurori i propozon Gjykatës së Apelit që ta kthejë çështjen në Gjykatën Themelore për rigjykim.

B) Ankesa e avokatit mbrojtës Z.J. në emër të R.R.:

28 - Avokati mbrojtës i R.R., Z.J. e shtyn Gjykatës së Apelit të modifikojë aktgjykimin e kundërshtuar, ta lirojë të pandehurin R. nga akuzat ose të prishë, anulojë dhe ta kthejë çështjen në Gjykatën Themelore për rigjykim dhe rivendosje. Ankesa bazohet në shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale (Neni 384 KPP), shkelja e ligjit penal (Neni 385 KPP) dhe në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike (Neni 386 KPP). Ankesa bazohet gjithashtu në vendimin për dënimin penal (Neni 387 KPP).

Avokati mbrojtës e përfundon kërkesën duke thënë "Unë do ta jap arsyetimin e ankesës me një parashtrësë të veçantë".

29 - Parashtrësja e cila përmbante arsyetimin kishte datën 15 mars dhe më pas u dorëzua në gjykatë më 11 prill 2017 dhe avokati mbrojtësi e quajti atë shtesë në ankesë (theksim i shtuar) ku thuhej si në vijim:

Sa i përket shkeljes së pretenduar substanciale të procedurës penale:

30 - Aktgjykimi është në kundërshtim me procedurën penale pasi Gjykata Themelore e bazoi aktgjykimin e saj vetëm në dëshminë e një dëshmitari, besueshmëria e të cilit është më shumë se e diskutueshme. Dëshmitari F.U. u tha kolegëve të tij se ai i njohu 3 deri 4 ose 4 deri 5 persona në barrikadën e dytë. Dëshmitari F.U. është i vetmi dëshmitar që i pa 10-15 persona në barrikadë, ndërsa të gjithë dëshmitarët e tjerë nuk përmendën më shumë se 8 persona, duke filluar nga 4 në 5 ose 7 deri në 8 persona. Dëshmitari F.U. i referohej të pandehurit R. si bjond, çka ai nuk është, dhe fillimisht përmendi një mbiemër të gabuar, emër të gabuar të babait, duke iu referuar një personi (burri) i cili i ka dy djem të një moshe të ngjashme me të pandehurin R. Dëshmitari F.U. e përmendi një lloj kontrolli trafiku kur R. nuk kishte pasur asnjë dokument identifikimi me vete. Ai tha se i ndjeri E.Z. ishte në patrullë me të në atë rast, por ai nuk mund ta konfirmojë atë, për fat të keq. Nuk ka prova të tjera.

31 - Gjithashtu, mënyra se si dëshmitari F.U. veproi gjatë seancave nuk e rriti besueshmërinë e tij pasi kishte frikë nga siguria e tij, refuzoi të dëshmonte dhe kërkoi një shtyrje.

32 - Dëshmitari F.U. ishte ulur në automjetin e blinduar prapa shoferit dhe bashkë-shoferit, ku nuk kishte ulëse horizontale (domethënë, të kthyera me fytyrë përpara), por kishte vende të palëvizshme anash në anën e majtë dhe të djathtë, të cilat ishin të mbështetura në anët e veturës dhe e kishin bllokuan pamjen midis shoferit dhe bashkë-shoferit. Gjithashtu, xhami i përparmë ishte i ndarë në mes nga një pengesë metalike dhe e gjithë sipërfaqja ishte e mbrojtur nga një rrjet metalik, i cili e zvogëloi shumë dukshmërinë.

33 - Duke marrë parasysh se aktgjykimi ishte i bazuar vetëm në dëshmitë e dëshmitarit F.U. dhe mospërputhjet e mësipërme të këtyre dëshmimeve, aktgjykimi bazohet në dëshmi jo të besueshme. Ekziston një mospërputhje e madhe midis dispozitivit dhe arsyetimit, ndërsa arsyetimi nuk tregon arsyet për faktet vendimtare. Si rrjedhojë, Gjykata Themelore shkeli Nenin 384 (1.12) të KPP në lidhje me Nenin 370 (7) të KPP, pasi gjykata e shkallës së parë ka bërë një vlerësim të gabuar të provave të administruara.

Sa i përket shkeljes së pretenduar të ligjit penal:

34 - Gjykata Themelore nuk ka konstatuar se i pandehuri ka kryer ndonjë veprim që mund të cilësohet si vepër penale, veçanërisht jo vepër penale për të cilën ai është shpallur fajtor dhe dënuar. Aktgjykimi gabimisht është bazuar në dëshminë e një dëshmitari të vetëm dhe jo të besueshëm.

Sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike:

35 - Gjykata Themelore e ka bërë një vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që e bazonte aktgjykimin e saj vetëm në dëshminë e një dëshmitari, F. U. .Kjo dëshmi nuk është e besueshme dhe gjithashtu i mungon çfarëdo baze. Dëshmitari F.U. ishte i anshëm dhe u përpoq të provonte me kokëfortësi se i pandehuri R.R. ishte në vendin e krimit.

36 - I pandehuri R.R. nuk ishte as fizikisht i pranishëm në vendin kritik as nuk ishte i përfshirë në veprim apo veprime. Sipas deklaratës së një dëshmitari të mbrojtur (Dëshmitari B.), R., në atë kohë, gjendej 200-300 metra larg, në një vend të caktuar, *d.m.th.* në depon e materialit ndërtimor, pranë së cilës ishte restoranti "Jelena Anzujaska", para të cilit R. e kishte parkuar veturën e tij, një Skoda e kuqe. Kjo u konfirmua nga shumë dëshmitarë dhe Gjykata Themelore e vërtetoi se distanca nuk ishte 200-300 metra, por 674 metra, dhe se vendi i ngjarjes nuk mund të shihej nga ai vend për shkak të konfigurimit të terrenit. Sipas dëshmisë së dëshmitarëve B. dhe dëshmitarëve të tjerë, R. u pa në vendin ku u dëgjuan të shtënat e para, por këto të shtëna ndodhën në kohën kur shoferi i veturës së blinduar u përpoq t'a largonte duke i shtyrë veturat që e formonin barrikadën. Ky ishte momenti kur njerëzit në barrikadë u larguan nga lokacioni i tyre dhe u larguan përgjatë rrugës drejt Zubin Potokut ose në pyll. Nuk ka mundësi teorike që R. të ishte në barrikadë kur u ndalua kolona.

37 - Aktgjykimi nuk është në përputhje, pasi që Gjykata Themelore e gjeti dëshminë e Dëshmitarit B. të besueshme, e cila mbështetej nga dëshmitë e dëshmitarëve të mbrojtjes, por të njëjtat dëshmi të dëshmitarëve të mbrojtjes (deklarata që ishin në përputhje me dëshminë e dëshmitarit B.) nuk u gjetën të besueshme. Një arsyetim i tillë, i panjohur për logjikën, është i paqëndrueshëm në të gjitha nivelet.

Sa i përket pretendimit për Dënimin Penal:

38 - Mbrojtja deklaron se aktgjykimi është i paqëndrueshëm edhe në lidhje me vendimin mbi dënimin penal, pa e përmendur llojin ose kohëzgjatjen e dënimit.

C) Ankesa e mbrojtësit A.L. në emër të M.:

39 - Avokati mbrojtës i M.V., A.L., i i propozon Gjykatës së Apelit të anulojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe ta kthejë çështjen për rigjykim. Ankesa bazohet në shkelje të konsiderueshme të dispozitave të procedurës penale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljen e kodit penal dhe vendimi mbi dënimin penal.

40 - Ai thekson se Prokuroria nuk ofroi asnjë provë e cila do të konfirmonte fajësinë e të pandehurit V. lidhur me veprat penale për të cilat u akuzua. Aktgjykimi i kundërshtuar nuk paraqet arsyetime të qarta dhe të arsyeshme për faktet dhe për çfarë arsye konsiderohen ato të dëshmuara ose jo të dëshmuara. Arsyet mbi faktet vendimtare janë krejtësisht të paqarta dhe ekziston një kontradiktë e dukshme midis asaj që del në dispozitiv dhe arsyetimit të aktgjykimit ose deklaratave të dhëna në procesverbal. {0}Mangësitë në aktgjykim shkelin dispozitat thelbësore të{/0} {1}procedurës penale sipas Nenit 384 (1.12) KPP në lidhje me Nenin 370 (7) të KPP.{/1}

Sa i përket shkeljes së pretenduar substanciale të procedurës penale:

41 - Së pari, Trupi Gjykoës në Gjykatën Themelore gjeti në Aktgjykim (faqe 33) se i pandehuri V. ishte në barrikadë me një grup njerëzish si pjesërisht të bazuar në deklaratën e Dëshmitarit B.. Megjithatë, sipas deklaratave të Dëshmitarit B. dhe identifikimit në shqyrtimin kryesor, Dëshmitari B. deklaroi se i pandehuri V. nuk ishte në vendin e ngjarjes. Kjo kontradiktë është në kundërshtim me Nenin 384 (1.12) në lidhje me Nenin 370 (7) të KPP.

42 - Së dyti, dëshmitari F.U. deklaroi në deklaratën e datës 26.07.2011 në stacionin rajonal të policisë në Mitrovicë se ai i identifikoi katër (4) persona, ndërkohë që nuk e përmendi ose nuk e

përshkroi fare personin nga albumi i fotografive numër 4, fotografia numër 1. Dëshmitari F.U., në deklaratën e tij të datës 29.07.2011, i përmendi të njëjtit njerëz si në deklaratën e datës 26.07.2011. Dëshmitari F.U. nuk e ka përmendur as nuk e ka dhënë një përshkrim të personit nga albumi i fotografive numër 4, fotografia numër 1 (a). Në bazë të raportit të policisë nga D.E. datë 30.07.2011, i cili ka marrë informacione nga një burim i panjohur i cili dëshironte të mbetet anonim, i pandehuri V. ishte në vendin e ngjarjes në veturën Opel Corsa me ngjyrë të panjohur (faqe 347 sipas CD të raporteve të policisë). Bazuar në atë që u tha më lartë, deklaratës së dëshmitarit F.U. nuk duhet t'i jepet kredibilitet, sepse mungesa e provave materiale dhe fakteve vërtetuese tregon se ai ka paragjykime.

43 - Aktgjykimi nuk mund të bazohet në supozime, por duhet të bazohet në dëshmi materiale, fakte të besueshme dhe të pakontestueshme. Pasi në këtë rast Gjykata Themelore nuk ka arritur të krijojë një bazë për sigurimin e konkluzionit të duhur, aktgjykimi është në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale Neni 384 (1.12) KPP në lidhje me Nenin 370 (7) të KPP dhe në kundërshtim me dispozitat e procedurës penale Neni 384 (2.1) KPP në lidhje me Nenet 3 dhe 7 të KPP.

44 - Lidhur me identifikimin, Dëshmitari F.U. deklaroi në deklaratën e datës 05 gusht 2011 se "ka pasur të tjerë, edhe më shumë se pesë (5) të tjerë, të gjithë së bashku dhjetë". Ai i përshkroi këta njerëzit e tjerë dhe karakteristikat e tyre dalluese duke deklaruar "I mbaj mend dy djem, ata ishin të gjatë dhe të rinj, më të rinj se të tjerët në atë grup prej pesë të cilët ishin duke bërë gjeste duke ngritur tre gishta dhe gishtin e mesëm..., unë mund t'i identifikojë ata, sepse i kam kushtuar shumë vëmendje këtij djali dhe një djali tjetër të ri, sepse nuk i kam njohur ata nga më parë" Dëshmitari F.U. nuk e dha ndonjë përshkrim të këtyre personave ose karakteristikave të tyre dalluese, por me kërkesë të policëve hetues për identifikimin e gjashtë albumeve fotografike, ai e identifikoi personin në fotografinë nën numrin 4 të albumit, të akuzuarin M.V.. Ky identifikim nuk ishte në përputhje me Nenin 255 të KPPK (të zbatueshëm në atë kohë) që rregullonte procedurën e identifikimit. Mbrojtja e kundërshtoi dëshmitë e dëshmitarit F.U. dhe propozoi që ajo të shpallet si e papranueshme. Gjykata Themelore nuk e dha ndonjë shpjegim për këtë pjesë dhe për këtë arsye aktgjykimi është në kundërshtim me procedurën penale sipas Neni 384 (1.12) të KPP në lidhje me Nenin 370 (7) të KPP.

Sa i përket vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë faktik:

45 - Përcaktimi i Gjykatës themelore i gjendjes faktike është i gabuar dhe jo i plotë sepse arsyetimi i aktgjykimit është vetëm një transferim i deklaratave të dëshmitarëve dhe deklaratave të dhëna në polici dhe në shqyrtimin kryesor dhe deklaratat e pjeshme nga argumentet përmbyllëse të avokatëve mbrojtës .Gjykata Themelore gjeti vetëm pjesërisht cilat fakte u gjetën të besueshme dhe të cilat jo. Për më tepër, Gjykata Themelore nuk e ka dhënë vlerësimin në lidhje me saktësinë e dëshmive kontradiktore - të shënuara më lartë në pikën Shkelje të konsiderueshme të procedurës penale - sipas Nenit 370 (7) të KPP në kundërshtim me Nenin 386 (2) dhe (3) të KPP.

Sa i përket shkeljes së pretenduar të Kodit Penal:

Gjykata Themelore nuk zbatoi parimin e supozimit të pafajësisë dhe *in dubio pro reo* pasi që konstatoi se veprimet e të pandehurit përmbushin veprën penale të përcaktuar në Nenin 318 të KPK.

Sa i përket pretendimit për Vendimin për Dënimin Penal:

47 - Gjykata Themelore nuk arriti të përcaktojë dënimin siç duhet duke marrë parasysh të gjithë faktorët relevantë.

D) Përgjigjet ndaj ankesave:

48 - Prokurori i EULEX-it në Prokurorinë e EULEX-it në Mitrovicë paraqiti përgjigje në lidhje me Ankesat e Mbrojtjes. Prokurori i EULEX - it propozon të refuzohen ankesat kundër aktgjykimit të gjykatës themelore duke u bazuar si në vijim:

49 - Lidhur me ankesën e R.R. , fillimisht Prokuroria deklaroi se do të jepte përgjigje kur i pandehuri të jep arsyetimin për Ankesën e tij.

50 - Lidhur me ankesën e M.V. , Prokuroria pohon se arsyet e parashtruara në Ankesë (në paragrafin e 3të në faqen 2) janë çorientuese, sepse Dëshmitari B. nuk ka deklaruar shprehimisht se i pandehuri M.V. nuk ishte i pranishëm, *se locus in quo* ishte si ai që është duke u sugjeruar në ankesë.

51 - Dëshmitari F.U. i identifikoi personat të cilët ai ishte në gjendje t'i njihje se ishin të pranishëm në *locus in quo*. Nuk është i diskutueshëm fakti që F.U. e ka identifikuar të pandehurin M.V. (shih procesverbalin e deklaratës së tij të dëshmitarit të datës 5 gusht 2011, faqet 1838 - 1849, në faqen 1841 të shkresave të lëndës). Rregullat e procedurës së identifikimit u zbatuan gjatë intervistave të kryera, duke përfshirë edhe intervistën me dëshmitarin F.U. Identifikimi u krye në përputhje me Nenin 255 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe Nenit 16 të Ligjit për Policinë Nr 03/L-035 të cilat ishin të zbatueshme në kohën e kryerjes së veprave penale. Për qëllimin e ligjshëm të zhvillimit të procedurës së identifikimit, përdorimi i fotografive plotëson kushtet e parashikuara në dispozitat e Nenit 255 të KPPK dhe Nenit 16 të Ligjit për Policinë Nr. 03/L-035.

52 - Nuk ka kontradiktë në deklaratat e dëshmitarëve, sepse provat e siguruar nga secili dëshmitar kanë të bëjnë me rrethanat që kanë të bëjnë me atë se çka secili dëshmitar individual ka parë ose vëzhguar në *locus in quo*.

E) Propozimi i Prokurorit të Apelit të Kosovës

53 - Prokurori i Apelit i propozon Gjykatës e Apelit të:

- dënojë të pandehurit R.R. dhe M.V. për veprat penale Dhënie e ndihmës për vrasje të pakujdesshme ose Dhënie e ndihmës për lëndime të rënda trupore dhe pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe t'u shqiptohet një dënim dukshëm më i lartë dhe
- Hudhet poshtë Ankesa e R.R. si e papranueshme në përputhje me Nenin 376, 379, 382 (1) dhe 398 (1.1) të KPP dhe

- Hudhet poshtë Ankesa e M.V. si e pabazuar.

54 - Lidhur me pranueshmërinë e ankesës R.R., pasi "shtesa" iu bashkua dosjes së lëndës, më 11 prill 2017, Prokurori i Apelit vëren se Ankesa nuk është në pajtim me Nenin 376 të KPP. As nuk lejon që Prokuroria apo Gjykata e Apelit të kuptojë qartë dhe të adresojë bazat për ankesë. Gjykata e Apelit duhet në të vërtetë të paraqes paanëshmëri strikte midis palëve në pajtim me Nenin 9 të KPP. Prandaj, kërkesa duhet të hudhet poshtë si e papranueshme. Nëse R.R. ose mbrojtësi i tij e plotësojnë ankesën e tij në një fazë të mëvonshme, kjo shtojcë do të anashkalonte afatin për të paraqitur ankesë sipas Nenit 380 (1) të KPP dhe do të pengonte ndjekjen penale në mënyrë efektive duke ushtruar të drejtën e saj për përgjigje sipas Nenit 388 (2) i KPP. Prandaj duhet të hudhet poshtë.

55 - Lidhur me pikën 1 të Aktakuzës, Prokurori i Apelit mendon se edhe nëse nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit kishin njohuri se njerëzit e tjerë në grup do të përdorin armë dhe do të fillonin të gjuajnë kundër oficerëve të policisë në kolonë, është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ata vërtet kishin njohuri për faktin se njerëz të tjerë të grupit i kishin mbushur armë në posedim të tyre dhe për prandaj për mundësinë që armët të përdroreshin në situatë. Gjithashtu është mjaft e qartë se përdorimi i mundshëm i armëve në një situatë të tillë do të çonte në dëmtim të rëndë trupor ose në rastin më të keq të vdekjes së personit që udhëtonte në kolonën e Policisë. Prandaj është mendim i Prokurorit të Apelit se të pandehurit kanë vepruar me neglizhencë dhe kanë kryer veprën penale dhënie e ndihmës / pjesëmarrje në vrasje neglizhente të E.Z. ose dhënie e ndihmës për t'i shkaktuar dëm të rëndë trupor E.Z. nga neglizhenca/pakujdesia.

56 - Lidhur me pikën 4 të Aktakuzës, barrikada e dytë nuk mund të shihet në izolim nga barrikada e parë dhe të shtënat pasuese. Grupi i ngjarjeve duhet të shihet në tërësinë e tij. Qartazi, sulmuesit i penguan oficerët e Policisë së Kosovës duke i detyruar ata të ndalonin me dy barrikada dhe pastaj duke gjuajtur në ta. Rrjedhimisht, nuk ka kuptim të konsiderojmë se barrikada e dytë ishte thjesht "rezistencë pasive" pa përdorimin e forcës. Barrikada e dytë në vete ishte vetëm një nga elementët e shumtë që përdroreshin nga sulmuesit për të penguar policët me forcë. Përdorimi i forcës dëshmohet nga përdorimi i dy barrikadave, armiçësia e dukshme e treguar nga grupi ndaj punonjësit e policisë dhe të shtënat e menjëhershme pasuese. Është e qartë se të dy të pandehurit i përkisnin grupit të armatosur që pengonte me forcë oficerët e Policisë së

Kosovës. Edhe pse roli i tyre nuk mund të dallohet qartë nga ai i të tjerëve, roli i tyre është i pandashëm nga ai i grupit të sulmuesve. Me thjeshtë pjesëmarrjen e tyre në grup, ata kontribuan në masë të madhe në kryerjen e veprës penale të pengimit të personave zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare. Prandaj, janë përmbushur kërkesat sipas Nenit 23 të KPK.

57 - Lidhur me ankesën e M.V., Prokurori i Apelit thekson se Gjykata Themelore ka vlerësuar si duhet dhe ka arsyetuar besueshmërinë dhe deklaratat e Dëshmitarit B. dhe Dëshmitarit F.U.. Sipas parimit të përgjithshëm të procedurës së apelit, Gjykata e Apelit duhet të japë një shkallë të mirëbesimit ndaj konstatimeve të fakteve të arritura nga trupi gjykues, sepse është trupi gjykues ai i cili është në pozitën më të mirë për të vlerësuar provat (Gjykata e Apelit, PAKR 1122 / 2012, Aktgjykimi nga data 25 prill 2013). Standardi, të cilin Gjykata Supreme në përgjithësi e zbaton, është “të mos trazoj gjetjet e trupit e gjykues, përveç nëse provat e mbështetura nga gjykata nuk do të mund të pranoheshin nga ndonjë gjykatë e arsyeshme, ose kur vlerësimi i saj është tërësisht i gabuar (Gjykata Supreme AP-KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, paragrafi 35, Gjykata Supreme, AP-KZi 2/2012, 24 shtator 2012, paragrafi 30.) Në rastin në fjalë, mbrojtësi nuk tregon se trupi gjykues ka arritur në një përfundim të gabuar të fakteve në lidhje me dëshmitë e Dëshmitarit B. ose të Dëshmitarit F.U., aq të padrejtë ose të paarsyeshme sa që të përbënin një shpërdorim të kompetencave diskrete.

58 - Vendimi për sanksionin penal do të ndryshohet për të qenë në përputhje me dënimet e parashikuara nga KPK për veprat penale të ndihmës për vrasje të pakujdesshme ose ndihmës për lëndime të rënda trupore dhe pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare. Dënimet e shqiptuara kundër të pandehurve për veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor dhe dënuar janë joadekuate dhe jo në përputhje me dispozitat e nenit 64 dhe 65 të KPK *pari materia* nenin 73 dhe 74 të KP 2013.

59 - Ankesat e Mbrojtjes nuk e trajtojnë fare çështjen, edhe pse ankimet paraqiten edhe në bazë të vendimit për sanksionin penal.

I. Gjetjet e Kolegjit të Apelit

A. Përbërja e kolegjit

60 - Kolegji konstaton se ky rast është përcaktuar si “në vazhdim e sipër” në përputhje me përkufizimin e përcaktuar në nenin 1 A të Ligjit mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë nr. 03 / L 053, të ndryshuar me ligjet nr. 04 / L-273 dhe 05 / L-103 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji mbi Juridiksionin). Me vendimin e datës 30 qershor 2017 (KGJK nr.229 / 7), KGJK ka vendosur që Kolegji të përbëhet nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar vendor dhe se gjyqtari i EULEX-it do të jetë kryetari i kolegjit. Prandaj, Kolegji është i përbërë në mënyrë të drejtë.

B. Ligji procedural në fuqi

61 - Kolegji konstaton se rrjedha e procedurave në këtë rast udhëhiqet nga KPP-ja pasi aktakuza është parashtruar më 8 maj 2014, me fjalë të tjera pas hyrjes në fuqi të KPP-së më 1 janar 2013 (Neni 545 (1) i KPP-së).

C. Pranueshmëria e ankesave dhe e përgjigjeve

62 - Në pajtim me nenin 380 (1) të KPP-së, personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë kundër aktgjykimit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit.

63 - Aktgjykimi i është dorëzuar Prokurorit të EULEX-it më 14 shkurt 2017. Prokurori i EULEX-it ka parashtruar ankesën e saj më 27 shkurt 2017. Ankesa e prokurorëve të EULEX-it është paraqitur brenda 15 ditëve të lejuara me KPP dhe nga një person i autorizuar. Prandaj, ankesa e Prokurorit të EULEX-it është e pranueshme.

64 - Aktgjykimi i është dorëzuar të pandehurit M.V. më 11 shkurt 2017 dhe avokatit të tij mbrojtës A.L. më 14 shkurt 2017. Ankesa është parashtruar më 24 shkurt 2017 nga mbrojtësi në emër të të pandehurit. Ankesa e M.V. u paraqit brenda 15 ditëve të lejuara me KPP dhe nga një person i autorizuar. Ankesa e M.V. është e pranueshme

65 - Aktgjykimi iu dorëzua të pandehurit R.R. më 14 shkurt 2017 dhe avokatit të tij mbrojtës Z.J. më 15 shkurt 2017. Parashtrësja e titulluar Ankesa është parashtruar brenda afatit më 1 mars 2017 dhe mbrojtësi e përfundon këtë parashtrësë duke theksuar “Arsyetimin e ankesës do të jap në një

parashtresë të veçantë”. Kjo parashtresë e fundit, megjithatë, që përmbante arsyetimin, mbante datën 15 mars dhe më pas u paraqit në gjykatë më 11 prill 2017 dhe mbrojtësi e quajti atë si shtojcë e ankesës (theksim i shtuar), duke dhënë arsyetimin e ankesës. Kolegji është i mendimit se ankesa e paraqitur më 1 mars 2017 nuk përputhet me kushtet e parashtruara për kundërshtimet dhe kërkesat për mjete juridike sipas nenit 376 të KPP-së, pasi ajo nuk ka arsyetim.

66 - Ankesa është parashtruar me kohë dhe nga personi i autorizuar, por Gjykata e hedh poshtë atë, duke mos e shqyrtuar fare, pasi që nuk është në pajtim me kushtet ligjore të përcaktuara në ligj, sipas nenit 376 (1.1.4 dhe 1.1. 7) dhe (4) KPP, 379 KPP, 382 (1.2) dhe neni 398 (1.1) dhe (3 - përcaktimi i përbashkët i të gjitha ankesave të të njëjtit aktgjykim).

Vendim i “refuzimit” do të nënkuptonte se bazat e ankesës së paraqitur më 1 mars 2017 ishin shqyrtuar, pavarësisht se arsyetimi i tij nuk ekzistonte në atë kohë. Kjo do të ishte një mënyrë (nëse do të pranohej nga Gjykata) për të anashkaluar afatet.

Siç u tha, arsyetimi mungonte (vetë avokati mbrojtës deklaroi se do ta dorëzonte atë më vonë, gjë që do të ishte e mundur, por vetëm brenda afatit, deri në përfundimin e orarit të punës). Në ankesë nuk kishte asnjë arsyetim që kishte të bënte me përshkrimin e fakteve relevante dhe bazën ligjore për mjetin juridik, sipas nenit 376 (1.1.4 dhe 1.1.7) të KPP-së. Sipas paragrafit 4 të këtij neni “nuk do të konsiderohet asnjë kundërshtim ose kërkesë që nuk është në përputhje me këtë nen” (theksuar në nenin 379 dhe 382 të KPP-së).

67 - Ankesa përfshin vetëm një listë të arsyeve ligjore pa ndonjë elaborim të tyre. Prandaj, siç u shpjegua dhe në bazë të nenit 376 (4) të KPP-së, Kolegji nuk do ta konsideroj këtë kërkesë për mjet juridik. Për më tepër, shtojca e ankesës - duke përfshirë arsyetimin për ankesën - edhe pse nga data 8 mars, është paraqitur më 11 prill 2017 dhe në vetvete do të ishte e vonuar sipas nenit 380 (1) të KPP-së. Për këto arsye, ky Kolegj e hedh poshtë ankesën dhe nuk e konsideron atë.

68 - Kolegji dëshiron të shtojë se afati i caktuar për ankesën kundër aktgjykimit sipas nenit 380 (1) të KPP-së nuk mund të anashkalohet duke paraqitur “një ankesë boshe” dhe duke dhënë një shtojcë të ankesës me përshkrimin e fakteve dhe bazës ligjore më vonë. Një procedurë e tillë nuk është në përputhje me nenet e KPP-së lidhur me procedurën e ankesave dhe prandaj nuk mund të pranohet.

69 - Ankesa e M.V. iu dorëzua prokurorit të EULEX-it më 1 mars 2017 dhe prokurori i EULEX-it brenda afatit paraqiti një përgjigje më 6 mars 2017 (388 (2) KPP). Ankesa e R.R. iu dorëzua prokurorit të EULEX-it më 6 mars 2017 dhe prokurori i EULEX-it brenda afatit paraqiti një përgjigje më 7 mars 2017 (388 (2) KPP). Prandaj, përgjigjet e Prokurorit të EULEX-it janë të pranueshme.

E. Gjetjet mbi bazat

E1. Afati i parashkrimit dhe ndalesa absolute mbi ndjekjen penale

70 - Fakti i padiskutueshëm është se ngjarjet e përshkruara në Aktakuzë u zhvilluan më 26 korrik 2011 dhe se hetimi policor filloi menjëherë pas incidentit.

Gjykata e Apelit, sipas detyrës zyrtare shpall ndalesën absolute mbi ndjekjen penale, duke konsideruar të dy të pandehurit lidhur me veprat penale në pikën V [Rrezikimi i trafikut publik me veprim apo mjete të rrezikshme, e përshkruar dhe e dënueshme sipas nenit 299 (1) të KPK, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia*, neni 380 (1) i KPRK-së, në lidhje me Nenin 31 të KPRK], neni 299 (1), i lexuar së bashku me nenin 90 (1.5) të KPK, 91 (1 dhe 6) i KPK dhe i refuzon akuzat në lidhje me këtë vepër penale, në pajtim me nenin 362 (1) dhe nenin 363 (1.3) të KPP-së, pasi afati i parashkrimit ka kaluar më 26 korrik 2017.

71 - Në të vërtetë, vepra penale në fjalë është e dënueshme me burgim deri në 3 vjet, që çon në afatin prej 3 vitesh të përcaktuar në nenin 90 (1.1.5) “Me përjashtim të rasteve kur është paraparë ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse nuk kanë kaluar tre vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim” dhe nenit 91 (6) të KPK-së, i cili parashikon që ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

72 - Në rastin në fjalë, duke marrë parasysh dënimet në kodin në fuqi në atë kohë dhe në kodin aktual të miratuar, nuk ka asnjë arsye për të elaboruar ligjin më të favorshëm, pasi rezultati do të ishte i njëjtë nëse do të zbatoheshin neni 106 dhe 107 (8) i KPRK-së.

Veprimet u kryen më 26.7.2011 dhe si rezultat ndalesa absolute mbi ndjekjen penale u bë më 26.7.2017, që çoi në refuzimin e kësaj pike të aktakuze me numrin V.

73 - Veprat e tjera penale me të cilat ngarkohen të pandehurit, duke ndjekur të njëjtën logjikë që u shpjegua më lart, dënimet përkatëse dhe dispozitat në fuqi, nuk e kanë arritur afatin e parashkrimit.

E2. Gabimet *De Minimus* në Aktgjykim (Neni 371 i KPP)

74 - Prokurori i EULEX-it thekson se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk është përpiluar sipas nenit 369 (2) të KPP-së, pasi zyrtari i regjistrimit nuk e ka nënshkruar aktgjykimin. Sipas nenit 371 (1) të KPP-së, palët kanë mundësinë të kërkojnë një vendim të veçantë për të korrigjuar ndonjë pasaktësi që mund të ketë ndodhur. Gjithashtu, Gjykata e Apelit mund të korrigjojë këto gabime në rast se ato janë objekt i një ankese në pajtim me nenin 371 (2) të KPP-së. Ky Kolegj është i mendimit se mungesa e nënshkrimit të zyrtarit të regjistrimit në aktgjykimin e Gjykatës Themelore është thjesht një gabim i vogël formal pa ndonjë efekt në përmbajtjen aktuale të aktgjykimit, në të cilin mund të kontribuojë fakti se në sisteme të ndryshme ligjore evropiane zyrtarët regjistruar nuk ekzistojnë fare dhe vetë gjyqtari e përpilon dhe e nënshkruan aktgjykimin.

75 - Prandaj, ky Kolegj vendos që kur dosja e lëndës t'i kthehet Gjykatës Themelore të Mitrovicës, zyrtari i regjistrimit (i cili është ende pjesë e stafit të EULEX-it) do të nënshkruaj aktgjykimin origjinal dhe t'ia vë datën, sipas datës kur kjo zhvillohet, pas vendosjes nga kjo Gjykatë.

76 - Duke marrë parasysh datën e Aktgjykimit, Prokurori i EULEX-it thekson se është vënë datë e gabuar dhe kundër nenit 369 (1, 2) dhe nenit 370 (2) të KPP-së. Kolegji pajtohet me Prokurorinë në lidhje me këtë: aktgjykimi me shkrim me të vërtetë mban datën 21 nëntor 2016, por aktgjykimi nuk ka të dhëna kur është përpiluar aktgjykimi me shkrim. Megjithatë, kjo mangësi nuk rezulton me anulimin e aktgjykimit ose në marrjen e vendimit për të kthyer çështjen në rigjykim. Përkundrazi, përsëri është një gabim *de minimus* i cili mund të korrigjohet, pasi ai

bie brenda fushëveprimit të nenit 371 “mangësitë në lidhje me formën e aktgjykimit me shkrim”, i cili sipas paragrafit 2 të të njëjtit nen mund të korrigjohet nga Gjykata e Apelit.

77 – Ka qenë e mundur të vërtetohet data kur është finalizuar (siç është shpallur në seancën publike të mbajtur), sepse aktgjykimi është dashur të përkthehej. Sipas informatave (që do të futen në dosjen e lëndës) të siguruar nga Gjykata Themelore e Mitrovicës, pas kërkesës së kësaj Gjykate, aktgjykimi është dërguar për përkthim më 7 shkurt 2017 dhe kjo është data që duhet merret në konsideratë dhe origjinali duhet të korrigjohet (data) në mënyrë të duhur.

E 3. Vërtetimi i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike - Fushëveprimi i shqyrtimit të ankesës

78. Kolegji thekson se si Prokurori i EULEX-it edhe mbrojtësi A.L., i dyti si avokat mbrojtës i M.V., ankohen kundër aktgjykimit të kundërshtuar lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

79 - Ky Kolegj është i vetëdijshëm se standardet e shqyrtimit të ankesës rrjedhin dhe deri në një farë mase e reflektojnë rolin e kufizuar të gjykatës së apelit në një sistem gjyqësor me shumë instanca. Si rregull i përgjithshëm, gjyqtarët e apelit kanë të bëjnë kryesisht me korrigjimin e gabimeve ligjore të bëra nga gjykatat më të ulëta, duke e zhvilluar ligjin dhe duke përcaktuar precedentë që do të udhëheqin rastet e ardhshme. Gjyqtarëve të Gjykatës Themelore, përkundrazi, u është besuar roli i zgjidhjes së kontesteve faktike relevante dhe marrja e vendimeve mbi besueshmërinë e dëshmimeve të dëshmitarëve, sepse ata i shohin dhe i dëgjojnë dëshmitarët duke dëshmuar. Gjetjeve faktike të gjyqtarit të trupit gjykues u jepet një nderim i madh, sepse gjyqtari ka kryesuar gjykimin, ka dëgjuar dëshminë dhe ka kuptimin më të mirë të provave në tërësi.

80 - Pra, pavarësisht nga kufizimet ose rastet kur është e nevojshme të merren prova të reja ose të përsëriten provat e marra, për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo plotë të gjendjes faktike [shih nenin 392 (1) të KPP-së - dhe në rastin e vërtetimit jo të plotë, varet edhe nga fakti dhe lloji i provave të kërkuara për t'i vërtetuar apo jo], Gjykata e Apelit duhet të largohet nga gjendja faktike sipas aktgjykimit të shkallës së parë dhe të vlerësojë arsyetimin e saj në aspektin e

provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor dhe të dhënave përkatëse që ndodhen në dosjen e lëndës.

81 - Standardi i shqyrtimit të ankesës për vërtetimin faktik është përcaktuar në nenin 386 të KPP. Ky nen thekson se nuk mjafton që të tregohet gabimi i pretenduar ose vërtetimi jo i plotë i faktit nga trupi gjykues. Përkundrazi, pasi kodi i procedurës penale kërkon që vërtetimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike të lidhet me një “fakt të rëndësishëm”, ankuesi duhet gjithashtu të vërtetojë se vërtetimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike, në të vërtetë ndërlidhet me faktin e rëndësishëm d.m.th. është vendimtar për vendimin e arritur.

82 - Vetëm kur ka gabime relevante (ose jo *de minimus*) në faktet e vërtetuara apo jo të vërtetuara, kundërthëniet midis fakteve, pamjaftueshmërisë relevante të gjendjes faktike [ose, sipas formulimit të nenit 403 (1) të KPP-së, “vërtetimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike”], ose arsyetimi në lidhje me faktet relevante mungon, kundërthënës ose i diskutueshëm, Gjykata më e Lartë duhet ose të marrë prova të reja ose të përsërisë provat tashmë të marra.

83 - Në lidhje me atë që u tha më lart, tani po e citojmë nenin 386 (1 dhe 2) të KPP-së, “ekziston një vërtetim i gabuar i gjendjes faktike kur gjykata ka vërtetuar gabimisht ndonjë fakt të rëndësishëm apo kur përmbajtja e dokumentit, procesverbalit mbi provat e shqyrtuara ose të incizimit teknik *seriozisht* (theks i shtuar) vënë në pikëpyetje saktësinë ose besueshmërinë e vërtetimit të fakteve të rëndësishme. (...) Ekziston një vërtetim jo i plotë i gjendjes faktike nëse gjykata nuk arrin të vërtetojë ndonjë fakt të rëndësishëm”.

84 - Këto rregulla shpjegojnë jurisprudencën e cituar, si një shembull nga Prokuroria e Apelit.

Në fakt, pavarësisht nga mospajtimi me përfundimin që ka të bëjë me klasifikimin e barrikadës së dytë, si një “rezistencë e thjeshtë pasive”, vetë Prokuroria e Apelit thekson se “është një parim i përgjithshëm i procedurave të apelit që Gjykata e Apelit të japë një hapësirë mbrojtjeje për gjetjen e faktit të arritur nga trupi gjykues, sepse është trupi gjykues ai i cili është vënë në pozitën më të mirë për të vlerësuar provat (Gjykata e Apelit, PAKR 1122/2012, Aktgjykimi nga data 25 prill 2013). Standardi të cilin Gjykata Supreme në përgjithësi e zbaton është <<të mos

trazoj gjetjet e trupit e gjykues, përveç nëse provat e mbështetura nga gjykata nuk do të mund të pranoheshin nga ndonjë gjykatë e arsyeshme, ose kur vlerësimi i saj është tërësisht i gabuar>> (Gjykata Supreme AP-KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, paragrafi 35; Gjykata Supreme, AP-KZi 2/2012, 24 shtator 2012, paragrafi 30) – Margjina e gjerë e nderimit u konfirmua edhe nga Gjykata Supreme në rastet e mëparshme *“të nderohet vlerësimi i trupit gjykues për besueshmërinë e dëshmitarëve të gjykimit që u paraqitën personalisht para tyre dhe që dëshmuuan personalisht para tyre. Nuk është e përshtatshme që Gjykata Supreme e Kosovës të anashkalojë vlerësimin e trupit gjykues për besueshmërinë e atyre dëshmitarëve, nëse nuk ka një bazë të arsyeshme për ta bërë këtë”*.

85 - Ky kolegji gjeti se faktet e vërtetuara nga gjykata e shkallës së parë janë të sakta dhe të vërtetuara dhe arsyetuara siç duhet, duke bërë të mundur që një vëzhgues objektiv të respektoj logjikën që nxjerr vendimin e tillë faktik. Megjithatë, do të shtohen disa referenca shtesë për arsyetimin e gjendjes faktike.

86 - Mbrojtësi A.L. në emër të të pandehurit M.V. në ankesën e tij thekson se dëshmia e dëshmitarit F.U. nuk ishte e besueshme dhe se aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte i gabuar pasi që ishte bazuar në këto prova. Për më tepër, e gjithë procedura e identifikimit e kryer gjatë hetimit policore pas incidentit ishte me të meta dhe për këtë arsye identifikimi i të pandehurit M.V. i kryer nga dëshmitari F.U. nuk ishte kryer në pajtim me nenin 255 të KPPK dhe prandaj dëshmia e tij nuk është dashur të konsiderohej assesi e pranueshme.

87 - Ky Kolegji pajtohet me analizën e bërë nga trupi gjykues i Gjykatës Themelore, pasi Gjykata Themelore vuri në dukje se dëshmitari F.U. e pa, e vëzhgoi dhe më pas e identifikoi në albumin e fotografive një fotografi të M.V. si njërin nga personat në barrikadën e vendosur për ndalimin e kolonës së Policisë së Kosovës.

88 - Procedurat u respektuan, siç shihet nga procesverbalet e ndryshme që janë mbajtur (shih procesverbalin e datës 5 gusht 2011 dhe 26 janar 2012), atij iu kërkua të jepte fillimisht një përshkrim, u informua për natyrën e veprimit që nuk duhej të identifikonte askënd dhe gjykata

nuk gjen asnjë shkelje të kushteve ligjore. Gjithashtu përputhjet midis përshkrimit dhe fotografive të zgjedhura janë të qarta.

89 - Edhe pse është foto nr. 1 nuk ka asnjë pengesë që dëshmitari të zgjedhë ndonjë nga fotot, nëse do të ishte foto nr. 6, atëherë argumenti do të ishte që kjo ka qenë fotografia e fundit në secilin album? Nuk ka nevojë të thuhet se argumenti është pa asnjë bazë ... nëse do të kishte dyshime, atëherë kjo Gjykatë thekson se në fotoalbumin nr. 2 ka pasur edhe një foto me nr. 1 dhe dëshmitari nuk e ka identifikuar atë person.

90 - Të dy të pandehurit u identifikuan nga dëshmitari edhe pse u ishin vënë emra të ndryshëm, nëse do të gënjente për t'i inkriminuar ata, atëherë ai do të kishte ndryshuar mënyrën se si u referohej atyre ... Përkundrazi, dëshmitari shpjegoi në mënyrë të detajuar se si i njohte ata nga e kaluara, nga njohja e tyre në mjedis, nga ndalimi i R. ca ditë më parë dhe "S." (V.) nga pompa e benzinës, duke shtuar detaje të tjera si në procesverbal - dhe gjatë gjykimit ai sqaroi se e mësoi emrin e të pandehurit V. nga mediat.

91 - Gjithashtu gjatë gjykimit ai shumë herë dha përgjigje të sinqerta dhe të thjeshta, duke thënë thjesht "nuk e di", duke përsëritur se nuk i mbante në mend aq mirë emrat dhe qëndroi pas deklaratave të tij të mëparshme, se njerëzit në barrikadë nuk kishin maska dhe gjithashtu nuk kishin armë.

92 – Në fund, sa i përket sjelljes së tij gjatë gjykimit, gjykata nuk sheh asnjë problem që një dëshmitar të ankohet për trajtimin, të mos ndihet mirë dhe që seanca duhet të ndërpritet. Shpesh dëgjohet, nga njerëz të ndryshëm, se ata që thirren (palët e dëmtuara, dëshmitarët, etj.) të jenë të pranishëm në gjykatë, ndjejnë se të pandehurit janë ata që trajtohen më mirë. Nëse parashikohet që të pandehurit trajtohen mirë gjatë një gjykimi dhe të respektohen të drejtat e tyre, është gjithashtu e vërtetë se i njëjti shqetësim me pjesëmarrësit e tjerë nganjëherë nuk është aq i dukshëm. Dëshmitari u ndje keq dhe i shqetësuar dhe seanca nuk mund të vazhdonte, kjo është e gjitha.

93. Kolegji gjithashtu thekson se dëshmitari F.U. ka marrë pjesë në hetimet policore më 26 dhe 29 korrik dhe më 5 gusht 2011 dhe më 26 janar 2012. Dëshmitari U. e ka identifikuar të pandehurin M.V. në deklaratën e tij dhënë policisë më 5 gusht 2011. Më vonë, në dëshminë e tij gjatë gjykimit më 20 janar 2015, dëshmitari U. i konfirmoi deklaratat e tij të mëparshme të dhëna gjatë hetimeve, gjithashtu edhe në lidhje me identifikimin. Në fund, dëshmitari F.U. u dëgjua më 20 shtator dhe më 10 tetor 2016 nga trupi gjykues në Gjykatën Themelore dhe dëshmitari U. e konfirmoi gjatë dëshmisë së tij identifikimin paraprak të të pandehurit M.V..

94 - Në të vërtetë dëshmitari është i besueshëm dhe nuk ka mospërputhje të mëdha midis deklaratave të tij të ndryshme. Nëse ai gënjeu për të inkriminuar të pandehurit, atëherë pse këta 2 individë të veçantë dhe jo të tjerët? - Gjykata mund të pyesë ... dhe pse ka thënë atëherë se ata nuk kishin armë, apo që nuk kanë ikur drejt pyllit kur filluan të shtënat? Sa i përket numrit të njerëzve që ai pa në barrikadë, përsëri nuk është thelbësor ndryshimi në mënyrën se si janë dhënë deklaratat në këtë drejtim, aftësia që të identifikojë 4 persona nga të pranishmit, të ketë parë më shumë se 5 persona, më shumë se 5 gjithsej 10 dhe se mund të kenë qenë prej 10 deri në 15 persona (deklaratat në data të ndryshme nuk janë kundërthënëse).

95 - Sa i përket identifikimit pozitiv të të pandehurit V., në të dyja rastet (marrja në pyetje më 5 korrik 2012 dhe gjatë shqyrtimit kryesor) dëshmitari tha të njëjtën gjë, ai ishte shumë aktiv në bërjen e gjesteve dhe e njihte nga pompa e benzinës.

96 - Përveç kësaj, Kolegji i referohet analizës së Gjykatës Themelore për besueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit F.U. dhe procedurën e identifikimit¹. Më tej ky Kolegj pajtohet me konkluzionin e Gjykatës Themelore që dëshmia e dëshmitarit F.U. është e rëndësishme dhe e sinqertë.

97 - Ky Kolegj gjithashtu tërheq vëmendjen për faktin se Gjykata Themelore i analizoi tërësisht “mospërputhjet” në deklaratat e dëshmitarit F.U. dhe i mori ato parasysh kur arriti një përfundim lidhur me vlerën dëshmuese të dëshmisë së tij.

¹ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në faqen 37 në versionin anglisht të Aktgjykimit të kundërshtuar.

98 - Si konkluzion, ky Kolegj është i mendimit se nuk ka asnjë arsye në ankesën e M.V., që të drejtoj këtë Kolegj për të vlerësuar besueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit F.U. më ndryshe nga trupi gjykues i Gjykatës Themelore. Me fjalë të tjera, mbrojtja nuk i siguron këtij Kolegji asnjë argument që provat në të cilat është mbështetur trupi gjykues nuk do të ishin pranuar edhe nga ndonjë gjykatë e arsyeshme faktike ose që vlerësimi do të ishte tërësisht i gabuar në lidhje me besueshmërinë e dëshmitarit F.U..

99 - Kolegji është i mendimit se pretendimet e mbrojtjes lidhur me sjelljen e pahijshme të pretenduar lidhur me identifikimin e të pandehurit M.V. gjatë hetimeve të policisë pas incidentit në vitin 2011 janë të pabaza, siç është shpjeguar më herët. Ky Kolegj thekson që Kryetari i Trupit Gjykues i Gjykatës Themelore të Mitrovicës ka nxjerrë një vendim më 18 korrik 2014, duke hedhur poshtë kundërshtimet e të pandehurit M.V., duke përfshirë edhe vërejtjet në lidhje me pranueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit F.U., e cila në atë kohë nuk u ankimua nga të pandehurit. Në fund, sipas procesverbalit të shqyrtimit kryesor, në fillim të rigjyimit, Kryetari i Trupit Gjykues dhe palët ranë dakord se cilët dëshmitarë duhet të dëgjohen gjatë rigjyimit. Përveç kësaj, u ra dakord që deklaratat nga shqyrtimi i parë kryesor vetëm do të lexoheshin pa rimarrjen në pyetje të dëshmitarëve gjatë rigjyimit.

100 - Sipas ligjit procedural, duke respektuar nenin 249 (1) të Kodit të Procedurës Penale, i pandehuri ka mundësi të paraqesë kundërshtime ndaj provave në Aktakuzë para shqyrtimit gjyqësor. Neni 249 (5 dhe 6) parasheh që (5) të gjitha provat për të cilat nuk është paraqitur asnjë kundërshtim janë të pranueshme në shqyrtimin gjyqësor, përveç nëse gjykata sipas detyrës zyrtare konstaton se pranimi i provave do të shkelte të drejtat e garantuara të të pandehurit sipas Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe (6) secila palë mund të ankimoj një vendim sipas paragrafit 3 të këtij neni. Ankesa duhet të bëhet brenda pesë (5) ditëve nga marrja e vendimit me shkrim.

101. Kolegji thekson se nuk ka pasur asnjë kundërshtim ndaj provave para shqyrtimit gjyqësor për rigjykimin dhe se Gjykata Themelore nuk ka nxjerrë asnjë vendim të posaçëm që lejon apo përjashton ndonjë provë në këtë rast. Përkundrazi, në fillim të shqyrtimit gjyqësor për rigjykim, u ra dakord se cilat prova dhe cilët dëshmitarë palët kishin kërkuar të jenë të pranishme në

shqyrtim gjyqësor. Kolegji më tutje konsideron se pretendimet e bëra nga mbrojtja lidhur me procedurën defektive të identifikimit janë të pabaza dhe prandaj nuk e shtyjnë Kolegjin që të konstatoj se pranimi i kësaj prove do të shkelte të drejtat e garantuara të të pandehurit, sipas Kushtetutës së Republikës e Kosovës.

102. Për këto arsye, Kolegji konstaton refuzimin e pretendimeve të mbrojtjes në lidhje me besueshmërinë e dëshmitarit F.U. dhe pretendimet në lidhje me procedurën e identifikimit të grupit të fotografive dhe shkeljet e pretenduara të nenit 255 të KPPP-së si të pabaza, siç është shpjeguar.

103 - Përveç kësaj, vlen të përmendet se thelbi i dëshmisë së F.U. u vërtetua nga dëshmitarët e tjerë të pranishëm, zyrtarët e policisë - jo miqtë apo të njohurit (si dëshmitarë të mbrojtjes) duke kujtuar detaje të plota edhe nëse përmbajtja e deklaratës lidhur me lëvizjet e të pandehurit R. nuk përputhet me të dhënat teknike të siguruara nga antenat - siç është theksuar shumë mirë nga shkalla e parë. Dhe i njëjti vlerësim vlen edhe për dukshmërinë brenda nga automjeti: siç e vë në dukje edhe gjykata e shkallës së parë, automjeti është i licencuar që të drejtohet në rrugë publike.

104 - Lidhur me Ë.B. (në seancën e mbajtur më 15 shtator 2016 është rënë dakord që të lexohet deklarata e mëparshme nga data 27 shkurt 2015), Gjykata nuk ka asnjë argument relevant për të shtuar, pasi shkalla e parë e ka adresuar siç duhet këtë çështje. Ë.B. dhe F.U. nuk ishin në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë, ata dëshmuuan momente të ndryshme të ngjarjes së përgjithshme.

105 - Gjithashtu edhe përpjekjet për të krijuar pamundësi ose kundërthënie në aktgjykim - qoftë pamja brenda nga automjeti, qoftë distanca që një i ri mund të ecë ose të vrapojë dhe sa kohë i duhet ..., sikur një distancë prej 674 metra të ishin në kilometra, qofshin të dhënat nga alibi kundrejt të dhënave teknike të siguruar nga antenat - janë të pabaza. Për këtë, shih faqet 33-36 të versionit në gjuhën angleze të aktgjykimit të kundërshtuar, që duhet lexuar së bashku me atë që u theksua më lart.

Gjithashtu Prokuroria (f. 15/16 e versionit në gjuhën angleze) pajtohet me arsyetimin e fakteve të vërtetuara.

E4. Analiza e pikave të aktakuzës që largohen nga të vërtetuarat

106 - Avokati mbrojtës i M.V. pretendon se nuk ka prova të besueshme që tregojnë se i pandehuri V. do të merrte pjesë në veprat penale të përshkruara në pikën 4 të Aktakuzës.

107 - Prokurori i EULEX-it dhe Prokurori i Apelit i propozojnë Gjykatës së Apelit që të shpall të pandehurit R. dhe V. fajtor për pengimin e personave zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare që është e dënueshme sipas nenit 316 (1) dhe (3) të KPK-së dhe nenit 409 (1) dhe (2) të KPRK.

108. Ky Kolegj thekson që Trupi Gjykses i Gjykatës Themelore konstatoi se veprimet e provuara të të pandehurve nuk përfshinin përdorimin e forcës, kërcënimeve të përdorimit ose kërcënimeve serioze siç kërkohet me nenin 316 (1) dhe (3) të KPK-së dhe nenin 409 (1) dhe (2) të KPRK-së. Megjithatë, Trupi Gjykses i Gjykatës Themelore gjeti se veprimet e provuara të të pandehurve përfshinin detyrimin e Policisë së Kosovës të ndaleshin në barrikadë, duke refuzuar t'i bindeshin urdhrave të dhëna nga Policia e Kosovës për të liruar rrugën, duke treguar shenja me dorë në mënyrë fyese dhe vulgare dhe duke bërë titur në Policinë e Kosovës. Kështu që Gjykata Themelore i shpalli të pandehurit fajtorë për pjesëmarrje në një grup që pengon personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare e përshkruar dhe e dënueshme sipas nenit 318 (1) të KPK-së².

109 - Duke marrë parasysh vlerësimin faktik të Gjykatës Themelore, ky Kolegj është i vetëdijshëm për standardin e shqyrtimit të ankesës. Kolegji, pasi ka kaluar nëpër procesverbalet e gjykatës, nuk mund të vërtetojë se veprimet e provuara të të pandehurve do të përfshinin diçka më shumë ose më pak nga ajo çfarë ka konstatuar Gjykata Themelore. Prandaj, Kolegji plotësisht pajtohet me vlerësimin faktik të kryer nga Trupi Gjykses i Gjykatës Themelore.

² Në aktgjykimin e kundërshtuar ndodh gabimi i njëjtë, kur përmendet kjo dispozitë, duke iu referuar “paragrafit 2” - kur nga aktgjykimi është e qartë se referimi është bërë në paragrafin 1, sepse paragrafi 2 janë rrethanat rënduese të “udhëheqësi i grupit që kryen veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni, dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet” dhe asnjëri prej të pandehurve nuk është dënuar si udhëheqës, si e tillë nuk është vërtetuar në aktgjykim. Kjo do të konsiderohet si një gabim në “numër”, sipas nenit 371 (1) dhe (2) të KPP.

110. Kolegji më tutje thekson se ankesa e të pandehurit V. bazohet në pretendimin se nuk ka pasur prova të mjaftueshme për të treguar pjesëmarrjen e tij në këto veprime dhe se dëshmia e dëshmitarit F.U. nuk ishte e besueshme. Lidhur me këtë pretendim dhe standardin e shqyrtimit të ankesës të përshkruar më lart, Kolegji konstaton se vlerësimi i kryer nga Gjykata Themelore në lidhje me besueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit F.U. është i mjaftueshëm. Për më tepër, mbrojtja e M.V. nuk është në gjendje të nxjerrë në pah një arsyetim përkatës të cilin Kolegji i Apelit do ta merrte në konsideratë ndryshe. Prandaj, ankesa e M.V. refuzohet në lidhje me pikën 4 të aktakuzës.

111 - Lidhur me ankesën e Prokurorit të EULEX-it dhe parashtresën e Prokurorit të Apelit mbi kualifikimin ligjor të veprës penale në pikën 4 të aktakuzës, ky Kolegj i hedh poshtë këto parashtresa, duke u bazuar në vijim.

112 - Neni 316 (1 dhe 3) i KPK-së, në fuqi në kohën e incidentit, parasheh: (1) (1) Kushdo që me dhunë apo me kanosje për përdorim të menjëhershëm të dhunës, pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare që bie në fushëveprimin e kompetencave të tij, ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyra zyrtare, dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet dhe (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni është kryer ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave të sigurimit publik, të sigurisë së Kosovës apo të ruajtjes së rendit publik, burgosjes së kryerësit të veprës penale apo të ruajtjes së personit të privuar nga liria, kryerësi dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet. Neni 409 (1 dhe 2) i KPRK thotë: (1) Kushdo që me forcë apo kanosje serioze, pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet dhe (2) Kushdo që merr pjesë në një grup të personave që me veprim të përbashkët pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet. Ndërsa, neni 318 (1) i KPK-së thotë: (1) Kushdo që merr pjesë në grupin e njerëzve që me veprim të përbashkët pengon apo tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose në mënyrë të ngjashme e

detyron të ekzekutojë detyra zyrtare dënohet për pjesëmarrje me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.

113 - Siç u shpjegua më parë, ky Kolegj pajtohet me vlerësimin faktik të Gjykatës Themelore. Bazuar në ankesën e prokurorëve të EULEX-it dhe në parashtresën e prokurorëve të apelit, e vetmja gjë që duhet të gjykohet është nëse veprimet e provuara të të pandehurve përfshijnë elementet përkatëse të përshkruara në nenin 316 (1, 3) të KPK-së (domethënë përdorimin e dhunës apo kanosjes për përdorim të menjëhershëm të dhunës) ose në nenin 409 (1, 2) të KPRK-së (domethënë përdorimin e forcës apo kanosjes serioze). Së pari, Kolegji thekson se veprimet e provuara të të pandehurve përfshijnë detyrimin e ndalimit të Policisë së Kosovës në barrikadë, duke refuzuar që t'i binden urdhrave të dhëna nga Policia e Kosovës për të liruar rrugën, duke treguar shenja me dore në mënyrë fyese dhe vulgare dhe duke bërë turp në Policinë e Kosovës. Ky Kolegj konsideron se nuk është vërtetuar se ndonjëri prej të pandehurve kishte përdorur ndonjë forcë gjatë kohës që ata ishin në barrikada që protestonin dhe merrnin pjesë në protestë. Prandaj, Kolegji vlerëson nëse veprimet e provuara të të pandehurve mund të cilësohen si kërcënime për përdorimin e menjëhershëm të forcës ose kanosjes serioze sipas neneve përkatëse. Ky Kolegj pajtohet se e gjithë situata në barrikadë (të dytë) ishte duke e penguar rrugën dhe duke refuzuar t'i bindeshin urdhrave të Policisë për të liruar rrugën, së bashku me fyerjet e bëra me gishta dhe britmat.

114 - Megjithatë, nuk ka fakte (ose prova që mund ta mbështesin) të vërtetuara se të pandehurit në fjalë kanë thënë ndonjë kërcënim serioz ose kërcënime për përdorimin të menjëhershëm të forcës ndaj Policisë së Kosovës. Veprimet e provuara të të pandehurve nuk mund të kualifikohen në mënyrën siç kërkohet me nenin 316 (1, 3) të KPK-së dhe nenin 409 (1, 2) të KPRK-së, pasi i mungojnë elementet thelbësore. Prandaj ankesa e Prokurorit të EULEX-it dhe propozimi i Prokurorit të Apelit refuzohen në lidhje me këto pretendime. Formulimi i kundërshtuar “rezistencë pasive” i përdorur nga Prokuroria nuk mund të jetë formulimi më i mirë i mundshëm, por në fakt ai e shpjegon të kuptuarit e Gjykatës, të kësaj Gjykate dhe të çdo vëzhguesi objektiv, lidhur me atë që të pandehurit po bënin (duke marrë pjesë): në një pengesë (jo një “sulm aktiv”) ndaj kalimit të kolonës së policisë.

115. Kolegji më tutje pajtohet me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në lidhje me kualifikimin e veprës penale të kryer nga Gjykata Themelore (përfshirja e bërë për bashkëkryerjen, siç do ta shohim më vonë). Gjykata Themelore ka vërtetuar saktë faktet dhe gjithashtu Kolegji i Gjykatës së Apelit pajtohet se veprimet e provuara të të pandehurve V. dhe R. kualifikohen në veprën penale “Pjesëmarrja në grupin që pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”.

E5. Pikat 1-3 - Bashkëkryerja dhe Ndihma

116 - Prokurori i EULEX-it në ankesën e saj pretendon se Gjykata Themelore nuk e ka zbatuar konceptin e bashkëkryerjes në Aktgjykim në lidhje me pikat 1-3 të Aktakuzës. Prokurori thekson se të pandehurit kanë vepruar në bashkëkryerje sipas përcaktimit të parashikuar në nenin 23 të KPK-së dhe në nenin 31 të KPRK-së dhe me veprimet e tyre kanë kontribuar ndjeshëm në kryerjen e këtyre veprave penale.

117 - Prokurori i Apelit pjesërisht e mbështet ankesën e Prokurorit të EULEX-it, duke pretenduar se të pandehurit duhet të shpallen fajtorë për veprën penale Ndihma / Bashkëkryerja për vrasjen nga neglizhenca të E.Z. ose Ndihmë në shkaktimin e lënimdit të rëndë trupor të E.Z. nga neglizhenca / pakujdesia.

Në lidhje me pikat I, II, III të aktakuzës

118 - Në lidhje me pika e aktakuzës 1, 2 dhe 3, ky Kolegj pajtohet me vlerësimin faktik të kryer nga Trupi Gjykses i Gjykatës Themelore. Nuk ka prova të drejtpërdrejta ose indirekte që vërtetojnë se veprimi i kërkuar do të përmbushej për këto pika të aktakuzës në lidhje me të pandehurit R. dhe V..

119. Kolegji më tutje thekson se Gjykata Themelore nuk e ka vlerësuar më tutje konceptin e bashkëkryerjes pasi që konstatoi se veprimi i kërkuar nuk ka mundur të vërtetohet në lidhje me të pandehurit. Në ankesën e prokurorit të EULEX-it pretendohet - ashtu si në Aktakuzë - se të pandehurit janë ngarkuar për bashkëkryerje në pikat 1, 2 dhe 3 pasi ata kanë kontribuar në masë të madhe për veprimet penale në këto pika të akuzës. Prandaj, ky Kolegji bënë vlerësimin e

pretendimeve lidhur me bashkëkryerjen dhe nëse të pandehurit mund të konsiderohen përgjegjës për pikat 1, 2 dhe 3 të aktakuzës në bazë të bashkëkryerjes së dyshuar.

120 - Neni 23 i KPK-së (dhe 31 i KKRK-së³) e përcaktojnë bashkëkryerjen si në vijim: “Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thellësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepra penale.” Elementet e bashkëkryerjes sipas këtyre neneve janë: numrat e personave, pjesëmarrja në kryerje ose dhënia e një kontributi vendimtar që është i rëndësishëm dhe pa të cilin vepra penale nuk do të kryhej, ose nuk do të kryhej në mënyrë të planifikuar dhe gatishmëria për të kryer një vepër penale si të tijën (qëllimi i përbashkët). Bashkëkryerja është një formë kryerjeje ku disa persona, secili prej të cilëve përmbushin elementet e kërkuara për kryerësin, me vetëdije dhe me dashje kryejnë vepra të caktuara kriminale. Në kundërshtim me ndihmësin ose shtytësin, bashkëkryerësit nuk marrin pjesë në një veprim të kryer nga një person tjetër. Një bashkëkryerës merr pjesë në veprimin e tij, ndërsa ndihmësit dhe shtytësit marrin pjesë në veprimin e dikujt tjetër.

121 - Bashkëkryerja është një koncept shumë kompleks që i nënshtrohet qasjeve të ndryshme doktrimore; ajo që përfshihet në nenin 31 të KPK-së është shumë e gjerë⁴. Në formën më të dukshme dhe më të qartë të bashkëkryerjes, duhet të ekzistoj një marrëveshje e mëparshme dhe reale, ndërsa në forma të tjera kjo “marrëveshje” vetëm mund të nënkuptohet [theks i shtuar]⁵, por në të dyja rastet, “pjesëmarrja” apo “kontributi i konsiderueshëm” përsëri duhet të çojë në një

³ Disa referenca do t'i bëhen Komentarit të KKRK-së lidhur me çështjen në fjalë, sipas natyrës teorike të cilës i referohet.

⁴ Në të njëjtën mënyrë, shih pikën 1 të Komentarit të Nenit 31 të KPRK. Për “lidhjet objektive dhe subjektive”, pikat 6 dhe 7 [“6. Lidhja objektive është se secili bashkëkryerës duhet të ndërmarrë një veprim me të cilin kontribuohet në kryerjen e veprës penale. Të gjitha veprimet që ndërmerren nga bashkëkryerësit, pavarësisht nëse ato ndërmerren në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend, duhet të jenë të ndërlidhura ndërmjet tyre dhe të drejtohen për të arritur të njëjtin rezultat, në mënyrë që të shkaktohen pasojat e përcaktuara. Me fjalë të tjera, pasoja e veprës penale duhet të jetë rezultati i përbashkët i veprimeve të të gjithë bashkëpunëtorëve. 7 Lidhja subjektive është se të gjithë bashkëkryerësit duhet të jenë të vetëdijshëm se do të marrin pjesë në kryerjen e një vepre penale të caktuar, do të veprojnë së bashku në mënyra të ndryshme (...)”].

⁵ Shih pikën 18A, në gjoba, të Komentarit të nenit 31 të KPRK-së, “duke u bazuar në këtë rezultat se bashkëkryerja mund të shprehet edhe në raste kur nuk ka pasur marrëveshje të mëparshme, por është shprehur në ndërkohë gjatë kryerjes. Lidhur me ekzistimin e bashkëkryerjes edhe ligjvënësi nuk e parashikon marrëveshjen si kusht të domosdoshëm”.

kontribut objektivisht të përbashkët gjatë kryerjes së të njëjtës veprë penale⁶; prandaj kërkohet që në aspektin e zbardhjes së fakteve të arrihet në përfundimin se individët donin të kryenin të njëjtën veprë penale (që së paku nënkupton njohurinë për veprën penale), që një rezultat i dhënë mund të arrihet si pasojë e veprimit / mosveprimit të tyre, por nuk është e nevojshme që të gjithë bashkëkryerësit të marrin pjesë në të gjitha veprimet e kryerjes.

122 - Rrjedhimisht, nuk ka nevojë për një marrëveshje të shprehur, pasi një bashkëpunim i ndërgjegjshëm në veprimet e të tjerëve⁷ për të përmbushur ose përfunduar veprën penale do të mjaftojë për bashkëkryerje. Ekziston një bashkëkryerje, përkundër faktit se nuk ka marrëveshje të shprehur, kur rrethanat në të cilat individi ka vepruar ose nuk ka vepruar tregon se ka pasur një marrëveshje të nënkuptuar. Kjo marrëveshje e nënkuptuar bazohet në ekzistimin e një vullneti të ndërgjegjshëm për të bashkëpunuar, vlerësuar në aspektin e përvojës së përbashkët. Pra, nëse në disa ngjarje marrëveshja ishte e qartë, është formuar dhe rregulluar paraprakisht, në ngjarje të tjera nëse nuk ishte e qartë ajo ishte të paktën e nënkuptueshme, duke iu bashkuar kryerjes në një fazë të caktuar. Ky është një rast i “bashkëkryerjes së njëpasnjëshme”. Bashkëkryerja e njëpasnjëshme ekziston në rastet kur një person tjetër i bashkohet personit i cili kryen veprën penale dhe me veprimet e tij merr pjesë në kryerjen e asaj veprë penale⁸, por veprimet gjithashtu mund të jenë edhe mosveprimet, “*Bashkëkryerja në veprat penale nga mosveprimi paraqitet në rastet kur dy ose më shumë persona së bashku janë të detyruar të ndërmarrin një veprim, por nuk e ndërmarrin atë*”⁹. Po ashtu ndodh kur vepra përbëhet nga veprimi dhe mosveprimi, dhe lëshimet mund të jenë, në rastin e zyrtarëve të kufirit, mos përmbushja e detyrave të tyre.

123 - Përfundimisht, bashkëkryerja është një nga elementet në të drejtën penale dhe nuk kërkon ose nënkupton se të gjitha elementet e tjera relevante në kryerjen e një veprë penale janë *ipso facto* të zbatueshme për të gjithë bashkëkryerësit, kjo do të thotë që jo domosdoshmërisht

⁶ Shih pikat 15 dhe 16 të Komentarit të nenit 31 të KPRK-së, “(...) së bashku kryejnë veprën e tyre të përbashkët, në të cilën secili prej tyre jep një kontribut të rëndësishëm pa të cilin vepra penale nuk do të arrihej ose nuk do të përfundohej (...). Kontributi i të gjithëve është një pjesë e rëndësishme e arritjes së planit kriminal. Kontributi i njërit përmbushet me kontributin e tjetrit dhe të gjithë janë përgjegjës për tërë veprën penale të kryer “.

⁷ Shih pikën 19 të Komentarit të Nenit 31 të KPRK-së në lidhje me konceptin e “bashkëkryerjes së domosdoshme”.

⁸ Shih pikën 22 a) të Komentarit të Nenit 31 të KPRK.

⁹ Shih pikën 22 c) të Komentarit të Nenit 31 të KPRK.

nënkuptohet se të gjitha elementet dhe rrethanat relevante që mund të gjenden në rastin e një bashkëkryerësi shprehen ose janë të zbatueshme tek të gjithë bashkëkryerësit (modalitetet e kryerjes së veprës penale, rrethanat lehtësuese dhe rënduese etj.); gur themeli është gjithmonë niveli i ndërgjegjësimit, i dashjes dhe i përgjegjësisë individuale - shih për shembull, në këtë aspekt, nenin 27 të KPK-së (ose nenin 36 të KPRK) mbi “Kufijtë e përgjegjësisë penale dhe ndëshkimi për bashkëpunim: (1) Bashkëkryerësi është penalisht përgjegjës brenda kufijve të dashjes apo të pakujdesisë së vet, ndërsa personi i cili shtytë ose ndihmon në kryerjen e veprës penale është penalisht përgjegjës brenda kufijve të dashjes së tij”.

124 - Në aspektin e asaj që u tha më lart, Prokuroria ka të drejtë kur pretendon se në bashkëkryerje nuk është e nevojshme që të gjithë bashkëkryerësit të marrin pjesë në të njëjtat veprime ose mosveprime ose dështim për të vepruar në të njëjtën kohë (“pjesëmarrja e të pandehurve (...) nuk kërkon nga ata që të jenë në posedim të armëve, por që kanë kontribuar në masë të madhe në kryerjen e atyre veprave penale”), por kjo është pjesë e ndërtimit doktrinor të bashkëkryerjes.

125 - Çështja, thelbi i problemit, është se faktet e rëndësishme si të tilla nuk janë vërtetuar, nuk është vërtetuar se të pandehurit disi ishin përgjegjës apo edhe të përfshirë (për të mos thënë të vetëdijshëm) në gjuajtje që fatkeqësisht çojnë në një vdekje dhe pa te nuk është e mundur të merret parasysh bashkëkryerja siç është interpretuar në kodin penal, Neni 23, “Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose duke i kontribuar në mase të konsiderueshme në kryerjen e saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprën penale”.

126 - Duke marrë parasysh që ky Kolegj pajtohet me konstatimet faktike të Gjykatës Themelore, ky Kolegj duhet të shtjellojë pak më shumë lidhur me çështjen nëse pjesëmarrja e të pandehurve në barrikadë mund të cilësohet si bashkëkryerje për veprat penale në pikat 1, 2 ose 3 ose siç paraqiten nga prokurori i apelit, duke ndjekur të kaluarën doktrimore të përcaktuar më sipër. Ky Kolegj së pari vëren se Gjykata Themelore në mënyrë të drejtë i shpalli të pandehurit (fajtorë për) pjesëmarrjen në grupin që pengonte personat zyrtarë, në protestën në barrikada kundër Policisë së Kosovës sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Sipas disa dëshmimeve të dëshmitarëve të

pjesëtarëve të Policisë së Kosovës që kanë qenë në vendin e ngjarjes, të pandehurit që morën pjesë në protestën në barrikada nuk ishin të armatosur. Sipas procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor dhe të aktgjykimit të Gjykatës Themelore Dëshmitari B. dëshmoi se kishte parë shpërndarjen e armëve dhe municionit dhe se personat afër Depos Varage kishin armë zjarri. Gjuajtja ndodhi pasi Policia e Kosovës filloi të thyejë barrikadën dhe protestuesit u tërhoqën në pyll. Në të vërtetë, askund në aktgjykimin nuk thuhet (dhe askush nuk e ngrit këtë çështje në ankesa) se ndonjëri ose dy të pandehurit shkuan në pyll.

127 - Ky Kolegj dëshiron të sqarojë se protesta që është konstatuar se kanë kryer të pandehurit kundër Policisë së Kosovës është një veprim i ndarë në raport me gjuajtjen që ndodhi pasi Policia e Kosovës filloi të thyejë barrikadat dhe protestuesit u tërhoqën, pavarësisht nga perspektiva kronologjike, gjuajtja ndodhi pas barrikadës dhe protestës. Pasi që nuk ka absolutisht asnjë provë lidhur me veprimet e të pandehurve pas përfundimit të protestës, është e pamundur të dihet roli i tyre në veprimet që u zhvilluan pasi u tërhoqën nga protesta. Edhe pse ky Kolegj konstaton se ekziston një mundësi e madhe që të Pandehurit ishin në një far mase të vetëdijshëm për armët e zjarrit dhe fakti që protestuesit tjerë ishin të armatosur, nuk është vërtetuar përtej bazës së arsyeshme se të pandehurit do të kishin kontribuar në masë të madhe në gjuajtje duke shkaktuar vdekjen e E.Z..

128 - Prandaj, ankesa e Prokurorit të EULEX-it refuzohet në këtë pjesë pasi që elementi i bashkëkryerjes nuk mund të vërtetohet lidhur me pikat 1, 2 dhe 3 lidhur me dy të pandehurit.

129 – Sa i përket kërkesës së Prokurorit të Apelit, Kolegji i referohet asaj që është thënë më sipër për gjetjet faktike të kryer nga Gjykata Themelore, bashkë-kryerja dhe më tej përkujton se Ndhima është përkufizuar në Nenin 25 (1 dhe 2) të KPK si më poshtë: (1) Kushdo që me dashje e shtytë personin tjetër të kryejë veprë penale dënohet si është parashikuar në Nenin 65(2) të këtij Kodi dhe (2) Ndhima për të kryer një veprë penale përfshin dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale; vënia në dispozicion e mjeteve për kryerjen e veprës penale; krijimi i kushteve ose mënjanimi i pengesave për kryerjen e veprës penale; ose premtimi paraprak se do të fshehë provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura

për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale. Përkufizimi është pothuajse i njëjtë në Nenin 33 (1 dhe 2) të KPRK-së.

130 - Kolegji e refuzon kërkesën e Prokurorit të Apelit që të pandehurit të shpallen fajtorë për Ndhimë/pjesëmarrje në vrasjen e Pakujdesshme të E.Z. ose Ndhimë për t'i shkaktuar lëndim të rëndë trupor E.Z. nga neglizhenca/pakujdesia. Duke iu referuar asaj që u tha më lart, nuk ka prova për veprimet e kryera nga të pandehurit pas tërheqjes së tyre nga protesta. Duke marr parasysh faktet dhe dëshmitë nuk mund të vërtetohet se të pandehurit do të kishin kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në gjuajtjen me armë që ndodhi pas tërheqjes së protestuesve dhe as që do të kishin ndihmuar në gjuajtje siç përshkruhet nga Prokurori i Apelit. Thjeshtë pjesëmarrja në protestë para se të ndodhte gjuajtja nuk mund të interpretohet në atë mënyrë që të pandehurit është dashur të dinë se pjesëmarrja në protestë në bllokimin e rrugës, se kjo pjesëmarrje do të rezultojë me të shtëna. Më tutje, ky Kolegj nuk është në gjendje të kualifikojë veprimet e të pandehurve në mënyrën që të pandehurit të shpallen fajtor për veprat penale të kryera nga neglizhenca. Siç u tha më parë, protestat dhe të shtënat ishin veprime të ndara, dhe është e pamundur t'i lidhim të pandehurit me të shtënat si kryes, bashkë-kryes ose ndihmës.

131 - Pa e deklaruar në mënyrë eksplicite, pasi një formë e tillë e përgjegjësisë penale nuk është e sanksionuar në të drejtën penale vendore, Prokuroria kryesisht ndjek logjikën që përputhet me Ndërmarrjen e Përbashkët Penale (NPK) në formën e saj të tretë. Largohet nga një grup (abstrakt), lidh ngjarje të ndryshme që ndodhën dhe pastaj dëshiron të shtrij përgjegjësinë penale për çdo veprim të personave të tjerë, *rectius*, të pandehurve të akuzuar dhe të shpallur fajtorë për kryerjen e një vepre penale lidhur me një veprim të caktuar brenda kontekstit të ngjarjeve që ndodhën në ditën kritike. Prokuroria e Apelit i drejtohet *Ndhimës në vrasje nga pakujdesia ose Shkaktimit të lëndimeve të rënda trupore*, por konstrukti / dhe faktet ligjore të cilat e mbështesin atë, jo vetëm që nuk ishin në aktakuzë (megjithëse Gjykata është e lirë të angazhohet në kualifikime të ndryshme të fakteve), por gjithashtu tani është duke u bërë pa baza faktike që kanë të bëjnë me të akuzuarit *mens rea* që mund të mbajë ate.

Atëherë ta trajtojmë NPK-në në fjalë dhe 3 format e saj, sipas analizës së Dhomës së Apelit për të Drejtën Ndërkombëtare Zakonore të Tribunalit të Hagës për Jugosllavinë.

1) Të gjithë bashkëpandehurit, duke vepruar sipas një plani të përbashkët, kanë të njëjtin qëllim penal; për shembull, formulimin e një plani midis bashkëkryerësve për të vrarë, ku, për ekzekutimin e këtij plani të përbashkët (dhe edhe nëse secili bashkë-kryerës kryen një rol të ndryshëm brenda tij), ata [...] të gjithë kanë qëllimin për të vrarë. Parakushtet objektive dhe subjektive për ngarkimin e përgjegjesisë penale ndaj një pjesëmarrësi i cili nuk ka kryer, ose nuk mund të vërtetohet se ka ekzekutuar materialisht vrasjen janë si vijon: (i) i akuzuari duhet të marrë pjesë vullnetarisht në një aspekt të planit të përbashkët (për shembull, duke i shkaktuar dhunë jo-fatale viktimës, ose duke ofruar ndihmë materiale ose duke lehtësuar aktivitetet të bashkë-kryerësve të tij); dhe (ii) i akuzuari, edhe nëse nuk e kryen vetë vrasjen, duhet të synojë këtë rezultat.

Kjo formë e NPK-së bën pjesë në konstruktin “klasik” të bashkë-kryerjes si mënyrë e pjesëmarrjes ose bashkëpunimit.

2) Është përshkruar si lloj i formës së parë dhe është konstatuar se ka shërbyer në rastet kur veprat penale të ngarkuara pretendohet se janë kryer nga pjesëtarë të njësive ushtarake apo administrative, siç janë ato që drejtojnë kampet e përqendrimit dhe “sistemet” e krahasueshme”: [“tre kushte të identifikuar nga Prokuroria si të nevojshme për të vërtetuar fajësinë në secilin rast: (i) ekzistenca e një sistemi të organizuar për keqtrajtimin e të burgosurve dhe kryerjen e krimeve të ndryshme të pretenduara; (ii) vetëdija e të akuzuarit për natyrën e sistemit; dhe (iii) fakti që i akuzuari në një far mënyre mori pjesë aktivisht për zbatimin e sistemit, *d.m.th.*, inkurajoi, ndihmoi dhe mbështeti ose në çdo rast mori pjesë në realizimin e planit të përbashkët kriminal. Bindjet e disa të akuzuarve duket se kanë qenë të bazuara në mënyrë të qartë mbi këto kritere. Kjo kategori e rasteve (e cila padyshim nuk është e zbatueshme për faktet e rastit aktual) është vërtetë variant e kategorisë së parë, e shqyrtuar më lart. Të akuzuarit, kur u shpallen fajtorë, u konsideruan bashkë-kryes të krimeve të keqtrajtimit, për shkak të qëllimit “pozitës së autoritetit” brenda sistemit të kampit të përqendrimit dhe për shkak se ata kishin “fuqinë për t’u kujdesur për të burgosurit dhe për ta bërë jetën e tyre të kënaqshme”, por nuk arritën ta bëjnë këtë”. Duket se në këto raste *actus reus* e kërkuar ishte pjesëmarrja aktive në zbatimin e sistemit represiv, siç mund të konkludohet nga pozita e autoritetit dhe funksionet e veçanta të mbajtura nga secili i akuzuar. Elementi *mens rea* përbëhej nga: (i) njohja e natyrës së sistemit dhe (ii) qëllimi për të avancuar planin e përbashkët për të keqtrajtuar të burgosurit. Është e rëndësishme

të theksohet se, në këto raste, qëllimi i kërkuar mund të konkludohet edhe nga pozita e autoritetit të mbajtur nga personeli i kampit]¹⁰.

Sa i përket formave të pjesëmarrjes ose bashkëpunimit në një vepër penale, Nenet 23 deri 26 të KPK-së *pari materia* Nenet 31 deri 36 të KPRK-së, veprimet ose mosveprimet, veprimet, duhet padyshim t'i përshtaten njërës prej formave të përcaktuara në ligj.

3) Karakterizohet nga një plan i përbashkët kriminal për të ndjekur një drejtim të sjelljes kur një ose më shumë bashkëkryerës kryejnë një veprim i cili, edhe pse jashtë planit të përbashkët, është pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e zbatimit të atij plani, pasojë e ekzekutimit të NPK-së (elementi objektiv ose *actus reus*) dhe i akuzuari (elementi subjektiv, për “gjendjen mendore” ose *mens rea*) ishte i vetëdijshëm për te (se krimi i diskutueshëm ose i kryer ishte pasojë e mundshme e ekzekutimit të NPK-së, dhe mori pjesë me atë vetëdije): “Ajo që kërkohet është gjendja mendore në të cilën personi, ndonëse nuk ka pas ndërmend të shkaktoj një rezultat të caktuar, ishte i vetëdijshëm se veprimet e grupit kishte shumë gjasa se do të çonin në atë rezultat por megjithatë me dëshirë e mori këtë rrezik. Me fjalë të tjera, kokrrohet i ashtuquajtur *dolus eventualis* (e quajtur edhe “pakujdesia e vëmendshme” në disa sisteme ligjore kombëtare)”¹¹. Për ta përmbledhur, ajo kërkon (i) Pluralitetin e personave. Ndërmarrja e përbashkët kriminale ekziston kur një numër personash marrin pjesë në realizimin e një qëllimi të përbashkët kriminal. Personat që marrin pjesë në ndërmarrjen kriminale nuk duhet të organizohen në një strukturë ushtarake, politike apo administrative.⁹⁵⁰ Ata duhet të identifikohen me specifike, për shembull me emër ose sipas kategorive ose grupeve të personave. (ii) Objektivi i përbashkët që ka ose përfshin kryerjen e një krimi të parashikuar (...). Forma e tretë e NPK-së varet nga fakti nëse është e natyrshme dhe e parashikueshme që ekzekutimi i NPK-së në formën e tij të parë do të çojë në kryerjen e një ose më shumë krimeve të tjera statutoare. Përveç qëllimit të formës së parë, forma e tretë kërkon dëshmi se personi i akuzuar ka marrë rrezikun që një krim tjetër ligjor, që nuk është pjesë e objektivit të përbashkët kriminal, por që megjithatë është pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e NPK-së, do të ishte kryer. Sipas Dhomës së Apelit, objektivi i përbashkët nuk është dashur të rregullohet ose formulohet më parë. Kjo do të thotë se elementi i dytë i NPK-së nuk nënkupton planifikim përgatitor ose marrëveshje të qartë midis pjesëmarrësve të NPK-së, ose ndërmjet pjesëmarrësve të NPK-së dhe personave të tretë. Për më tepër, NPK-ja

¹⁰ Shih f. 88, 89 të Aktgjykimit të Apelit në Gotovina et al.

¹¹ Idem, f. 99.

mund të ekzistojë edhe nëse asnjë ose vetëm disa prej kryesve kryesorë të krimeve janë anëtarë të NPK-së. Për shembull, NPK-ja mund të ekzistojë në rastet kur asnjë prej kryesve kryesorë nuk është i vetëdijshëm për NPK-në apo objektivin e saj, por sigurohen nga një ose më shumë anëtarë të NPK-së për të kryer krime që e shtyjnë atë objektivi. Prandaj, “për të mbajtur një anëtar të NPK-së përgjegjës për krimet e kryera nga jo-anëtarët e ndërmarrjes, duhet të tregohet se krimi mund t’i numërohet një anëtari të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, dhe se ky anëtar - kur e përdorur një kryes kryesor - veprimi në përputhje me planin e përbashkët”. (iii) Pjesëmarrja e të akuzuarit në zbatimin e objektivit. Kjo arrihet me kryerjen e krimit nga ana e të akuzuarit që është pjesë e objektivit të përbashkët (dhe parashikohet në Statut). Përndryshe, në vend që të kryejë krimin e synuar si kryes kryesor, sjellja e të akuzuarit mund ta plotësojë këtë element nëse përfshinte shkaktimin ose dhënien e ndihmës për ekzekutimin e një krimi që është pjesë e objektivit të përbashkët. Kontributi i një personi të akuzuar për NPK nuk duhet të jetë, si çështje ligjore, e nevojshme ose substanciale, por duhet të jetë së paku një kontribut i rëndësishëm për krimet për të cilat i akuzuari është shpallur përgjegjës. Lidhur me dy elementët e para të përgjegjësisë së NPK-së, është objektivi i përbashkët që fillon të transformojë shumëllojshmërinë e personave në një grup, apo ndërmarrje, sepse ajo që ky pluralitet pastaj ka të përbashkët është objektivi i veçantë. Është e qartë, megjithatë, se vetëm objektivi i përbashkët nuk është gjithmonë i mjaftueshëm për të përcaktuar një grup, sepse grupe të ndryshme dhe të pavarura mund të ndodh të ndajnë objektiva identike. Prandaj është ndërveprimi ose bashkëpunimi ndërmjet personave - veprimi i tyre i përbashkët - përveç objektivit të tyre të përbashkët, që e krijon grupin nga pluralizmi i thjeshtë. Me fjalë të tjera, personat në ndërmarrje kriminale duhet të tregohet se vepronë së bashku, ose në bashkëpunim me njëri-tjetrin, për zbatimin e një objektivi të përbashkët, nëse ata duhet të ndajnë përgjegjësinë për krimet e kryera përmes NPK-së¹².

132 - Duke e thënë këtë, përsëri dhe si gjithmonë, faktet e vërtetuara janë premisa e ligjit, *da mihi factum dabo tibi jus*, ose “më jepni faktet dhe unë do t’ju jap Ligjin”. Forma e 3-të e NPK-së, sipas mendimit të këtij kolegji, nuk mund të pranohet përtej fushëveprimit *dolus eventualis*, qëllimi eventual [Neni 15(3)] dhe, meqë të gjitha format e neglizhencës dhe qëllimit, mund të nxirren nga faktet (shih Nenin 22 të KPRK-së i cili e ruan në mënyrë të qartë këtë parim), norma e tillë duhet të lexohet bashkë me lidhjen shkakore dhe përgjegjësinë për pasojat të rënda (Nenet

¹² Dhoma e Apelit në Gotovina et al.

14 dhe 17 të KPK-së)¹³. Megjithëse kjo mund të duket e tepruar për të qenë e qartë, disa recitale dhe interpretime mbi formën e 3-të të NPK-së pothuajse lënë hapësirë për një përgjegjësi penale objektive, ku një individ mund të shpallet fajtor për një veprë penale të kryer në favor të një tjetri me të cilën ai/ajo është e lidhur, për aq sa mund të interpretohet ose konsiderohet si “pasojë e parashikueshme” e kësaj të fundit. Gjithashtu, sistemet e ndryshme janë më të rrepta se të tjerat kur bëhet fjalë për kufijtë e përgjegjësive penale¹⁴.

133 – Meqë, pavarësisht nga ajo që u tha më lart, nuk mund të vërtetohet se të pandehurit kanë marrë pjesë në gjuajtje gjithsesi, pasi që nuk u vërtetua se ata disi ishin përfshirë (ose madje kishin njohuri) për veprimet tjera (veprime apo mosveprime) përveç atyre që janë vërtetuar.

134 - Për më tepër, nuk ka fare dëshmi se gjuajtja e automjeteve ishte planifikuar të kryhet në çdo rast, pavarësisht se çfarë ndodhe (dhe kjo nuk mund të nxirret nga shpërndarja e armëve, gjithashtu sepse askush nuk di se kujt i ishin shpërndarë dhe kush ishte në gjuajtjen nga pylli). Ajo që dihet është se gjuajtja ndodhi kur Policia filloi të lëvizë për të tërhequr makinat, gjë që çon në pyetjen: po të kishte qenë vendimi i policisë ndryshe (për shembull, thjesht të kthehen dhe të shkojnë prapa), a do të kishte ndodhur ndonjë gjuajtje? Kjo nuk është vërtetuar, domethënë, ekzistenca e planit për të kryer gjuajtjen e tillë sidoqoftë nuk ishte pjesë e aktakuzës, shumë më pak e vërtetuar. Po të ekzistonte një plan i tillë, dhe të pandehurit ishin pjesë e tij, atëherë do të ishte e mundur të analizoheshin se deri në ç'masë mund të konsideroheshin përgjegjës për pasoja

¹³ Në KPRK-së, përkatësisht: *Lidhja shkakore*, “Personi nuk është penalisht përgjegjës nëse nuk ka lidhje shkakore midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave” (Neni 20 KPRK); *Përgjegjësia për pasoja me të rënda*: “Kur kryerja e një veprë penale shkakton pasoja të cilat e tejkalojnë qëllimin e kryerësit dhe ligji ka parashikuar një dënim më të rëndë, dënimi më i rëndë mund të shqiptohet nëse pasoja i atribuohet pakujdesisë së kryerësit” (Neni 24 KPRK), dhe *kufijtë e përgjegjësive penale dhe dënimi për bashkëpunim*: “Bashkë-kryesi është penalisht përgjegjës brenda kufijve të dashjes apo të pakujdesisë së tij ose të saj. Personi i cili nxit apo ndihmon në kryerjen e veprës penale duhet të mbahen penalisht përgjegjës brenda kufijve të dashjes se tij ose të saj, + çështjen e rrethanave që kanë të bëjnë me paligjshmërinë apo fajin e njërit prej autorëve në raport me të tjerët ... (Neni 36 KPRK)”.

¹⁴ Në qoftë se një nga pjesëmarrësit kryen një krim që nuk është parashikuar në qëllimin e përbashkët ose projektin e përbashkët, ai/ajo vetëm do të pësojë përgjegjësinë penale për një krim të tillë; këto vende janë Gjermania, Holanda dhe Portugalia. Vendet tjera gjithashtu mbështesin parimin, nëse personat që marrin pjesë në një plan të përbashkët ose projekt të përbashkët për të kryer një krim, të gjithë janë penalisht përgjegjës për një krim tjetër, pavarësisht nga roli i luajtur nga secili prej tyre, në qoftë se njëri prej personave që marrin pjesë në planin ose ndërmarrjen e përbashkët kriminale kryen një veprë tjetër që ishte jashtë planit të përbashkët, por , megjithatë , “i parashikueshëm”, këto vende janë Franca ose Italia.

me të rënda (lëndime të lehta ose të rënda trupore, madje edhe vdekje, që rezultojnë nga gjuajtja në oficerët e policisë ose automjetet me individë brenda) ...

135 - Nuk ka përgjegjësi “objektive” në të drejtën penale; është parim themelor që secili i pandehur duhet të shpallet penalisht përgjegjës vetëm brenda kufijve të fajit të vet, *nulla poena sine culpa*, dhe nga ky këndvështrim, kjo Gjykatë tërheq vëmendjen ndaj dispozitave të mëposhtme të KPK-së: Neni 11, Përgjegjësia Penale “(1) Një person është penalisht përgjegjës nëse ai ose ajo është mendërisht i aftë dhe është shpallur fajtor për kryerjen e një vepre penale. Një person është fajtor për kryerjen e një vepre penale kur ai ose ajo kryen vepër penale me dashje ose nga neglizhenca” (është theksuar) dhe Neni 14, Lidhja Kauzale, “një person nuk është penalisht përgjegjës nëse nuk ka lidhje shkakore midis veprimit ose mosveprimit dhe pasojave ose nuk ka mundësi për realizimin e pasojave”, aktualisht të parashikuara në Nenet 17 dhe 20 të KPRK.

136 - Për të gjitha që u thanë më lart, sa i përket pikave 1, 2 dhe 3, ky Kolegj pajtohet plotësisht me vlerësimin e bërë nga Gjykata Themelore dhe gjen pa merita arsyet e Prokurorisë dhe të Prokurorit të Apelit.

Lidhur me Pikën IV

137 - Ky Kolegj pajtohet me faktet dhe kualifikimin ligjor sipas Nenit 318(1) të KPK-së, sepse referencat në paragrafin 2 janë qartë gabime shtypi, duke marrë parasysh jo vetëm faktet e vërtetuara, por edhe referencat e duhura të bërë edhe në aktgjykimin e kundërshtuar në paragrafin 1.

138 - Nuk ka nevojë të thuhet se të gjithë kryesit e veprës se tillë penale përfundojnë duke vepruar së bashku brenda kontekstit dhe konceptit të grupit, por arsyeja për të pasur një vepër penale autonome përtej konceptit të kufizuar ose klasik (forma më e qartë e përmendur më herët) e bashkëpjesëmarrjes ishte të sigurohej, për të lehtësuar, mbrojtjen e vlerës juridike, duke pasur parasysh se një grup ka një dinamikë të ndryshme vetvetiu, gjë që rrit rrezikshmërinë.

Teknika legislative e përdorur mund të jetë e diskutueshme, sepse për shembull, vlera juridike e mbrojtur në KPRK nuk është veprë penale autonome, por është pjesë e përshkrimit të veprës penale e pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, paragrafi i dytë aktual i Neni 409 të KPRK-së, por kjo Gjykatë nuk pajtohet me Gjykatën Themelore se pjesëmarrja në grup nuk kërkon bashkëveprim, e cila po kundërshtohet nga Prokuroria: kriteri ligjor i zbatuar nga Gjykata Themelore kur i shpalli ata kryes, jo bashkë-kryes, por këtu kjo Gjykatë, siç u tha tashmë, nuk pajtohet me shkallën e parë, kur konstatoj se të pandehurit nuk kanë vepruar në bashkëkryerje sipas Neni 23 KPK.

139 - Veprimi për këtë veprë penale është të merr pjesë në një grup të personave [“kushdo që merr pjesë në një grup të personave që me veprime të përbashkëta pengon (...)”], që është akt (individual) që nuk nënkupton bashkë-kryerje rreptësisht (*stricto sensu*), forma e qartë dhe klasike e bashkëkryerje siç u shpjegua më herët (plan i qartë, që ekziston nga fillimi ose *ab initio*, ekzekutimi i përbashkët ose kontributi thelbësor në rezultatin e paraparë penal).

140 - Në këtë rast, dhe përsëri duke iu referuar asaj që Gjykata theksoi më lart mbi teorinë e bashkëkryerjes, ky është rast i saj nëse jo eksplisit, të paktën është implicit, marrëveshja për një plan kriminal, duke iu bashkuar (nëse jo që nga fillimi) ekzekutimit të një veprë penale që po ndodh - është rasti i kryerjes së njëpasnjëshme, siç u shpjegua. Prandaj, duhet t’i referohemi Neni 23 të KPK-së, bashkë me Neni 313(1) të KPK-së.

141 - Prandaj, në dispozitiv dhe në arsyetimin e bazës ku të pandehurit janë shpallur fajtorë për veprën penale Pjesëmarrje në Grupin që pengon personat zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare sipas Neni 318 (1) të KPK-së, është referuar Neni 23 i KPK-së, bashkëkryerja.

142 – Prokurorja e EULEX-it në ankesën e saj pretendon se Gjykata Themelore gaboi në arsyetimin e saj në pikat 5 dhe 6 pasi të dyja veprat janë të veçanta dhe të ndara. Arsyetimi i Gjykatës Themelore sa i përket parimeve të bashkëveprimit të dukshëm real, pajtimit ideal dhe subsidiaritetit është i gabuar.

143 - Gjykata Themelore konstatoi se veprat penale në pikat 5 dhe 6 janë në lidhje bashkëveprimi me njëra-tjetrën. Për më tepër, Gjykata Themelore ka gjetur se bashkëveprimi i dukshëm në bazë të subsidiaritetit ekziston dhe se krimi i veçantë (Rrezikimi i Trafikut Publik) konsumon krimin e përgjithshëm (Shkaktimi i Rrezikut të Përgjithshëm).

Gjykata e Apelit do të vazhdojë të adresoj secilën një nga një.

Lidhur me Pikën V

144 - Vepra penale në fjalë është “Rrezikimi i trafikut publik me akt apo mjete të rrezikshme, të përshkruara dhe të dënueshme sipas Nenit 299(1) të KPK-së, lidhur me Nenin 23 të KPK-së *pari materia* Neni 380(1) i KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së”

Dënimi i paraparë në Nenin 299(1) të KPK-së përcakton hapësirën e dënimit të mundshëm deri në tre vjet. Neni 380(1) i KPRK-së parashikon të njëjtën kohëzgjatje me burgim si dënim maksimal. Pasi që kjo vepër penale dënohet me burgim deri në 3 vjet, ajo çon në zbatimin e periudhës së parashkrimit prej 3 vjetësh: sipas Nenit 90 (1.5) të KPK-së, “përveç nëse parashihet ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të fillojë pas kalimit të periudhave të mëposhtme: (...) Tre vjet nga kryerja e veprës penale e dënueshme me burgim më shumë se një vit”, ndërsa sipas Nenit 91(1) “afati i parashkrimit i ndjekjes penale fillon në ditën kur është kryer vepra penale” dhe, sipas paragrafit 6, të të njëjtit Nen, “ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur ka kaluar dyfishi i afatit të parashkrimit (parashkrimi absolut i ndjekjes penale)”- është theksuar.

145 - Neni 363(1.3) i KPP, në anën tjetër, thotë “gjykata do të merr aktgjykim për refuzimin e akuzës, nëse (...) ka kaluar afati i parashkrimit (...)”, parashkrimi dhe parashkrimi absolut i ndjekjes penale ka ndodhe më 26 korrik 2017 dhe ky Kolegj e refuzon aktakuzën në këtë pjesë, siç u shpjegua.

146 - Prandaj, Gjykata e Apelit *sipas detyrës zyrtare* e shpall parashkrimin absolut për ndjekje penale duke pasur parasysh dy të pandehurit lidhur me veprën penale në pikën V, në pajtim me Nenin 299 (1) të KPK-së, lidhur bashkë me Nenet 90 (1.5) KPK, 91 (1 dhe 6) të KPK-së dhe

Nenet në vijim 362(1) dhe 363(1.3) të KPP-së Gjykata e refuzon akuzën lidhur me veprën penale.

Lidhur me Pikën VI

Asnjë nga veprimet materiale që përbëjnë veprën penale nuk ishin, ose nuk mund, të vërtetohen. Prandaj, nuk është e qëndrueshme të mbrohet pas ankesës që të pandehurit duhet të shpallen fajtorë për këtë vepër penale.

Lidhur me Pikën VII

147 - Prokurori i EULEX-it pohon se në pikën 7 të aktakuzës, Gjykata Themelore gabimisht konstatoi se ishte mendim i përgjithshëm se turma duhet të jetë më e madhe se shtatë (7) ose së paku dhjetë (10) persona. Prokuroria pretendon se sipas mendimit të Gjykatës Supreme më 21 tetor 2010 lidhur me Nenin 320 (1) të KPK-së, Turmë e mbledhur nënkupton 8 ose më shumë persona. Dispozitat e Nenit 412 të KPK 2013 qartë theksojnë se turma e mbledhur përbëhet nga tetë ose më shumë persona.

148 – Duke pas parasysh se tani është një rikualifikim në Pikën IV me të cilën pajtohet Gjykata e Apelit, në këtë pikëpamje kjo Pike duhet të adresohet, për të vlerësuar nëse ka fakte që përputhen me elementet përbërëse të veprës penale dhe nëse ekziston bashkëveprimi real i veprave penale apo me tepër bashkëveprimi i dukshëm.

149 - Sidoqoftë, përpara se të adresohet bashkëveprimi ligjor dhe modalitetet e saj, është e përshtatshme të bëhet dallimi në lidhje me termat tjerë, domethënë bashkëveprimi ideal dhe real, pasi bashkëveprimi ideal dhe real janë koncepte të ndryshme lidhur me *actus reus*, nëse me një veprimi material, që nënkupton një akt apo një lëshim, sipas terminologjisë së përdorur në nenin 8 (1) të KPRK-së (më e saktë se ajo e përdorur në Nenin 20 të KPRK-së, ku “veprimi” përdoret kur “vepra” duhet të jetë fjala e duhur, për dallim nga “mosveprimi”) është kryer më shumë se një vepër penale (bashkëveprim ideal) ose me më shumë se një vepër materiale (reale) është kryer më shumë se një vepër penale. Gjithashtu, në të dyja rastet, bashkëveprimi mund të jetë

homogjen (lloj i njëjtë i veprës penale) ose heterogjen (lloj i ndryshëm i veprave penale), varësisht në çfarë vlere juridike, dispozite fajësuese është kryer (vepra penale).

150 – Me sa duket, faktet e vërtetuara dhe qëllimi i dëshmuar janë pikat fillestare të çdo rishikimi ose korigjimi ligjor. Është vërtetuar (dhe kjo Gjykatë pajtohet) se të pandehurit donin të merrnin pjesë, të merrnin pjesë në një grup që pengon personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare - sipas Nenit 318(1) të KPP-së.

151 - Duke thënë këtë, është koha që të trajtohet bashkëveprimi ligjor i dispozitave penale, i njohur gjithashtu si bashkëveprimi i dukshëm.

Janë tre lloje të marrëdhënieve midis normave fajësuese, përfshirja (apo absorbimi)¹⁵, subsidiariteti dhe veçantia.

Të fillojmë me përfshirjen ose absorbimin: Mund të themi se një vepër penale përfshin një tjetër kur kryerja e veprimit (vetvetiu) përbën vetvetiu kryerjen e veprës penale (të absorbuar), por në rast është vetëm pjesë e kryerjes (mjet për, ose veprim i ekzekutimit) të një veprë më të rëndë penale. Vendimi për të cilën vepër penale duhet të shpallet fajtor i akuzuari, do të varet nga faktet, edhe lidhur me *actus reus* edhe me *mens rea* - të paktën të dëshmuara, nëse nuk janë vërtetuar direkt, sepse ne mund të gjejmë raste kur vepra me e rëndë është përtej qëllimit, për shembull në rastet e përgjegjësisë për pasoja më të rënda (Neni 24 i KPRK-së), pasi që mund të kemi edhe raste kur vepra penale më pak e rëndë është vetëm kryerja e veprës penale më të rëndë me dashje, duke qenë shembull tipik i veprës penale të lëndimit trupor të absorbuar me vrasje (me dashje).

Sa i përket subsidiaritetit, ai ekziston kur ka mbizotërim ligjor që i jepet normës penale që përmban një dënim më të lartë, por nëse pragu për dënim ose të gjitha elementet përbërëse të veprës penale nuk janë plotësuar, atëherë duhet të zbatohet vepra penale subsidiare (përderisa janë përmbushur të gjitha elementet përbërëse të veprës penale më të butë - nuk ka nevojë të thuhet ...), pasi ligjvënësi e sheh veprën penale më të butë si “valvul sigurie” për të shmangur që një lloj veprimi të mos kalojë pa dënim - *lex primaria derogat lex subsidiariae*.

¹⁵ Pavarësisht vështirësia e përkthimit e koncepteve kontinentale ligjit të doktrinës ligjit penal për formulimin që mund të ketë kuptim në gjuhën angleze (për të mos përmendur se Ligji Common ndryshon thellësisht nga ligji Kontinental modele penale, si gjermanisht dhe frëngjisht, të cilat kanë ndikuar pjesa më e madhe vendet) ne do të trajtojmë vetëm thelbin e këtij ndërtimi ligjor, pasi ajo paraqet edhe lloje të ndryshme të modaliteteve.

Në fund, veçantia ekziston kur një fakt është - me sa duket - në kundërshtim me më shumë se një normë penale, por njëra nga këto norma përmban një plus në raport me tjetrën në bashkëveprim të dukshëm. Vendimi për lidhjen e veçantisë është vlerësim i përgjithshëm, nuk varet nga rasti konkret ose nga pragu i dënimit; ai nuk varet në vlerësimin e fakteve, por ai më shumë mbështetet në interpretimin sistematik dhe kuptimin e vlerave të mbrojtura penale; ai ekziston kur një veprim më i veçantë ose më i detajuar është objekt i një vepre penale autonome, për shembull, vrasje kundër vrasjes së foshnjave pas lindjes, pasi kjo e fundit gjithashtu përfshin vrasjen - *lex specialis derogat generali*).

Në kundërshtim me atë që Prokuroria thotë, konstruktet dhe teoritë doktrinale nuk janë as të parëndësishme as nuk synojnë zëvendësimin e ligjit, ato janë pjesë përbërëse e teorisë kriminale në këndvështrimin e të cilave duhet të kuptohen dhe zbatohen dispozitat penale.

Në këtë rast, dhe lidhur me veprën penale të përcaktuar në Nenin 320 të KPPK, jo vetëm që faktet materiale nuk janë vërtetuar në lidhje me shumicën e veprimeve që përbëjnë këtë veprë penale (vetëm elementet objektive “ose kryen vepra të tjera më të dhunshme, ose tenton të kryej vepra të tilla” mund të konsiderohet, sepse me sa duket nuk është e diskutueshme që faktet nuk mund të interpretohen si përmbushje e elementeve të tjera, “me veprimin kolektiv privon personin tjetër nga jeta, shkakton lëndim të rëndë trupor ndaj personit tjetër, shkakton rrezik të përgjithshëm, dëmton pronën në shkallë të madhe” – meqë lidhur me vrasjen nuk ekziston faji, siç e pamë më parë), por gjithashtu, në lidhje me pjesëmarrjen në turmë që kryen një veprë penale (pika VII, Neni 320 PCCK) vs. merr pjesë në një grup personash të cilët me veprime të përbashkëta pengojnë ose tentojnë të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare (pika IV, Neni 318 KPPK), do të mbulohet nga parimi i veçantisë, sepse “veprimi më i veçantë ose më i detajuar është objekt i një vepre penale autonome” – një grup i personave të cilët me veprime të përbashkëta pengojnë ose tentojnë të pengojnë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare. Është vlerësim i përgjithshëm, që nuk varet nga rasti konkret ose në pragun e dënimit; nuk varet nga vlerësimi i fakteve, më shumë mbështetet në interpretimin dhe kuptimin sistematik të vlerave të mbrojtura penale, siç u tha më lart. Prandaj, të pandehurit duhet të lirohen nga kjo akuzë.

152 - Përveç kësaj, pavarësisht nga rezultati i këtij aktgjykimi, duke përfshirë edhe ndryshimin e vendimit të shkallës së parë, Kolegji është i kënaqur me arsyetimin faktik dhe ligjor të kryer nga Gjykata Themelore.

E 6 Vendimi mbi sanksionimin penal

153 – Edhe Prokurori i EULEX-it edhe Prokurori i Apelit kërkojnë nga Gjykata e Apelit të ndryshoj Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe të ndryshoj dënimin si duhet. Për më tepër, Prokurori i Apelit i konsideron dënimet, e shqiptuara të pandehurve për vetëm një veprën penale që u shpallen fajtorë nga Gjykata Themelore, tepër të buta dhe në kundërshtim me Nenet 64 dhe 65 të KPK *pari materia* Nenet 73 dhe 74 të KPRK.

154 - Avokati mbrojtës i M.V. u ankua lidhur me vendimin mbi sanksionin penal. Megjithëse formulimi i përdorur në ankesë nuk është i qartë, është e kuptueshme se po kundërshtohet dënimi dhe po kërkohet një dënim më i butë nga kjo Gjykatë –në rast se mbështetet, në tërësi, aktgjykimi i Gjykatës Themelore.

155 - Sa i përket përcaktimit të dënimeve, gjendja faktike duhet të ndryshohet, të plotësohet, në përputhje me Nenin 403(1) lidhur bashkë me Nenin 392 *a contrario*, pasi provat përkatëse dokumentuese të tilla janë në dosjen e lëndës – periudha që ka të bëjë me të dy të pandehurit lidhur me periudhat që ata ishin në liri (siç e ka përmendur këtë Gjykata Themelore vetëm lidhur me të pandehurin R.R.).

156 - Nga regjistratorët e paraburgimit është e mundur të vërtetohet se më 11 gusht 2011, Gjyqtari i procedurës paraprake i EULEX-it ka lëshuar urdhër arrestet kundër R.R. dhe M.V.. Natyrisht, R. u arrestua më 11 prill 2014 (ai ishte në arrati 2 vjet e 8 muaj) dhe M.V. u arrestua më 3 shkurt 2014 (ai ishte në arrati 906 ditë, që do të thotë gati 2 vjet e 6 muaj – siç ka vënë në dukje Gjykata Themelore.

Sa i përket dënimit të më mëparshëm të të pandehurit R.R. [përkatës në pajtim me Nenin 64(1) të KPK-së, për kriterin “sjellja e mëparshme e kryesit”, dhe si dënim të mëparshëm - pasi aktgjykimi ka datën 11/11/2002], Gjykata Themelore përmend se ai “ishte dënuar për veprë shumë të rëndë penale vrasje”. Është e vërtetë se ishte vrasje, por ajo ishte vrasje nga pakujdesia duke përdorur armën, për të cilën ai u dënua me 9 muaj burgim, në bashkëveprim me veprën penale grabitje, për të cilat ai është dënuar po ashtu me 9 muaj burgim dhe dënimi unik me 16 muaj (1 vit e 4 muaj) – aktgjykimi mund të gjenden në ndarësin 15 të regjistratorit II të gjyqimit.

157 - Para procedurës, është e rëndësishme të merret parasysh kjo në vijim: pavarësisht nga fakti ankesa e të pandehurit R.R. është hedh poshtë, shkelja e ligjit penal mund të vlerësohen *ex officio* në kuadër të shqyrtimit nga Gjykata e Apelit, në përputhje me nenin 387 (1), 394 (1.4) të KPP Dhe pse Gjykata po e thotë këtë? - Sepse në qoftë se është gjetur ndonjë shkelje e ligjit penal sa i përket dënimit, atëherë ajo do të duhej të vlerësohej nëse është e “natyrës personale” e të të pandehurit M.V., atëherë parimi *beneficium cohaesionis* (Neni 397) duhet respektuar.

158 - Tani të kthehemi te aktgjykimi i Gjykatës Themelore, sepse rrethanat rënduese kanë vlerë për të dy të pandehurit. Me gjithë respektin e duhur për mendim të ndryshëm, ky Kolegj nuk pajtohet me Gjykatën Themelore, sa i përket faktit se ata kishin ikur dhe rrethanës së tretë rënduese, se arsyeja e thirrur bën pjesë në mbrojtjen e vlerës juridike nga vepra penale me të cilën të pandehurit u shpallen fajtorë, pjesëmarrje në grup që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, sipas Neni 318 (1). I njëjti fakt nuk mund të merret parasysh dy herë për qëllime të ndryshme, përkatësisht në kuadër të Neni 64 KPP, që rregullon përcaktimin e sanksionit.

159 - Prandaj, ankesa e paraqitur nga avokati mbrojtës i të pandehurit M.V. është pjesërisht e bazuar, si në përcaktimin e dënimit. Prandaj, ky Kolegj vendos të zvogëloj gjatësinë e dënimit të zbatuar për të pandehurin M.V., në 3 muaj dhe dënimi i tij është ndryshuar dhe tani është vendosur në 1 vit e 3 muaj burgim; periudha e verifikimit mbetet e pandryshuar (3 vjet).

160 – Meqë motivi që drejton këtë kolegji të zvogëlojë sanksionin e shqiptuar këtij të pandehuri nuk është i “natyrës thjesht personale”, por më shumë është çështje juridike e interpretimit të ligjit, atëherë zbatohet parimi *beneficium cohaesionis* (Neni 397).

Si rrjedhojë, dënimi konkret i shqiptuar të pandehurit R.R. do të zvogëlohet gjithashtu për 3 muaj.

Rrjedhimisht, dënimi i R.R. ndryshohet dhe tani është caktuar në 1 vit e 9 muaj burgim; perioda e verifikimit mbetet e pandryshuar (4 vjet). Si në aktgjykimin e kundërshtuar, në përputhje me Nenin 73 (1) të KPK-së, koha në paraburgim dhe e privimit nga liria nga 11 prilli 2014 deri më 22 prill 2015, do të përfshihet (zbritet) nga dënimi në rast se revokohet dënimi me kusht.

161 - Duke pasur parasysh ankesën e Prokurorit të EULEX-it për të shpallur të pandehurin fajtorë sipas Aktakuzës dhe për të ndryshuar dënimin në përputhje me të, pjesërisht i mbështetur nga Prokurori i Apelit. Veç kësaj Prokurori i Apelit pohon se dënimet e shqiptuara të pandehurve bazuar në vetëm një veprë penale me të cilën u shpallen fajtorë në Gjykatën Themelore janë tepër të buta dhe nuk janë në përputhje me Nenet përkatëse të KPK-së dhe KPRK.

162 - Megjithatë, duke u mbështetur vetëm në atë që ishte vendosur lidhur me përcaktimin e dënimeve dhe zvogëlimin e tyre, ky Kolegj nuk e miraton ankesën e Prokurorisë, gjithashtu në këtë aspekt, dhe e refuzon atë si të pabazuar për atë çështje.

163 - Pra, dhe si abstrakte:

- Gjykata e Apelit ex officio shpall parashkrimin absolute për ndjekje penale sa u përket dy të pandehurve lidhur me veprën penale në pikën V, në pajtim me Nenin 299 (1) të KPK-së, lidhur me Nenet 90 (1.5) të KPK-së, 91 (1 dhe 6) CCK. Në bazë të neneve 362 (1) dhe 363 (1.3) të KPP, meqë perioda absolute e parashkrimit ka skaduar më 26 korrik 2017, Gjykata e refuzon akuzën lidhur me veprën penale në pikën V të Aktakuzës.

- Ankesa e parashtruar nga avokati mbrojtës Z.J. në emër të të pandehurit R.R. e datës 27 shkurt 2017 është hedhur poshtë, nuk është marr parasysh, sepse nuk përputhet me kërkesat ligjore të përcaktuara në ligj, sipas Neneve 376 (1.1.4 dhe 1.1.7) dhe (4) të KPP, 379 CPC, 382 (1.2) dhe Neni 398 (1.1) dhe paragrafit 3 (përcaktimi i përbashkët i të gjitha ankesave të të njëjtit aktgjykim).

- Ankesa e paraqitur nga Prokurori i EULEX-it më 27 shkurt 2017, për të marrë parasysht ekzistencën e bashkëkryerjes (suksesive) në Pikën IV, në pajtim me Nenin 23 të KPK-së është miratuar.

Pjesa tjetër është refuzuar si e pabazuar.

- Ankesa e paraqitur nga avokati mbrojtësi i të pandehurit M.V. sa i përket shkeljes së ligjit penal për përcaktimin e dënimit është miratuar dhe si rrjedhojë, kohëzgjatja e dënimit të shqiptuar është zvogëluar në 3 muaj.

Pjesa tjetër e ankesës është refuzuar si e pabazuar.

- Të pandehurit M.V. i është ndryshuar dënimi dhe i është caktuar në 1 vit e 3 muaj burgim; periudha e verifikimit mbetet e pandryshuar (3 vjet).

- Të pandehuri R.R. i është ndryshuar dënimi dhe i është caktuar në 1 vit e 9 muaj burgim – ndryshim për shkak të parimit *beneficium cohaesionis*; periudha e verifikimit mbetet e pandryshuar (4 vjet). Si në aktgjykimin e kundërshtuar, në përputhje me Nenin 73 (1) të KPK-së, koha në paraburgim dhe privimi nga liria nga 11 prilli 2014 deri më 22 prill 2015, do të përfshihet (zbritet) nga dënimi në rast se revokohet dënimi me kusht.

- Në pajtim me Nenin 398 (1.4), lidhur Nenin 370 (1 dhe 2) dhe 403 të KPP, e korigjon datën e aktgjykimit origjinal në 7 shkurt 2017 dhe procesmbajtësin, i cili është ende anëtar i stafit të EULEX-it, do të nënshkruaj aktgjykimin origjinal dhe e shkruan datën me datën që ajo ndodhë, pas vendimit nga kjo Gjykatë.

- Në pajtim me nenin 370 (1 dhe 2) në aktgjykimin e shkallës së parë ku shkruan Neni 318 (2) i KPK është një gabim shkrimi që duhet të lexohet “Neni 318 (1) i KPK” - në përputhje me paragrafin e fundit të faqes 39 të versionit në Anglisht.

- Në dispozitiv dhe bazat faktike ku të pandehurit janë shpallur fajtor për veprën penale Pjesëmarrjes në grup që pengon personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare sipas Neni 318 (1) KPK-së, është bërë referencë Neni 23 i KPK, bashkëkryerje, (suksesive).

- Sa i përket pjesës tjetër, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. nr. 61/2016 të datës 21 nëntor 2016 në këtë mënyrë mbështet.

Arsyetimi është kryer më 7 dhjetor 2017.

Kryetari i Kolegjit

Jorge Martins Ribeiro
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtës

Timo Torkko

Zyrtar Ligjor në EULEX

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS
PAKR 158/17
7 dhjetor 2017

Anëtar i Kolegjit

Hava Haliti
Gjyqtare e Gjykatës së Apelit të Kosovës